Lurimi Shpk

Bashkia Prrenjas

Relacioni i Planit të Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore "Prrenjas"

2025 - 2034



BASHKIA PRRENJAS

Plani i Mbarështimit i Pyjeve dhe Kullotave të Ekonomisë pyjore "Prrenjas" për periudhën 2025- 2034

KONSULENTI "LURIMI"SHPK

Administrator

(Ekspert per vegjetacionin dhe biodiversitetin)
(drejtues teknik i kompanise)

Inxh. Lutfi Miftari

Plani i mbarështimit u hartua nga ekspertë të kompanisë LURIMI shpk

Ekipi i konsulencës		
Ekspert kyç	Emër Mbiemër	Pozicioni
K-1	Vasillaq Mine	Statisticien pyjesh
K-2	Endri Bala	Ekspert GIS
K-3	Bibe Dodaj	Ekspert per terrenin
K-4	Lutfi Miftari	Ekspert per vegjetacionin dhe biodiversitetin

Kodi ALFIS:

Data e miratimit:

SHKURTESA

PMPK	Plan i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave
EP	Ekonomi Pyjore
PM	Plan Mbarështrimi
NjA	Njësi Administrative
MM	Ministria e Mjedisit
AKP	Agjencia Kombëtare e Pyjeve

I. Table of Contents

I. Table of Contents 5
A. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 9
I. Hyrje 14
I.1 Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave 14
I.2 Ecuria e punës dhe përgjegjësitë 15
I.3 Metodologjia e punës 17
I.4 Informacioni i përdorur në përgatitjen e PMPK 19
II. Përshkrim i përgjithshëm i bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore Prrenjas. 20
II.1 Informacion i përgjithshëm rreth Bashkisë dhe ekonomisë pyjore 20
Figura II.1 Teritori i bashkisë Prrenjas, me Njësitë Admnistrative 21
II.2 Pronësia, administrimi dhe organizimi 22
II.3 Vendndodhja gjeografike dhe administrative 24
II.4 Konteksti i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore 24
II.5 Historiku i mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave në Ekonominë Pyjore 25
II.6 Situata demografike dhe socio-ekonomike 26
II.7 Tregtimi i prodhimeve pyjore drusore dhe jodrusore 29
II.8 Gjuetia dhe peshkimi 30
II.9 Infrastruktura rekreative dhe didaktike 30
II.10 Prania e siteve dhe specieve me vlera të larta mbrojtjeje 31
III. Situata aktuale e pyjeve dhe kullotave 31
III.1 Mbarështrimi dhe funksionet e pyjeve dhe kullotave 31
III.1.1 Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet) 31
III.1.2 Regjimi i qeverisjes (aktuale dhe propozimet) 33
III.1.3 Ndarja e Ekonomisë Pyjore në parcela dhe n/parcela 34
IV. Përshkrimi i stacionit 35
IV.1 Klima 35
IV.2 Topografia dhe morfologjia 37
IV.3 Gjeologjia 41
IV.4 Tokat 43

IV.5 Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë 44
IV.6 Erozioni në sipërfaqet e pjerrëta dhe rrjedhat ujore 46
IV.7 Rrëshqitjet e tokës 46
V. Vegjetacioni dhe biodiversiteti 46
V.1 Brezat bio-klimatikë 46
V.2 Pyjet dhe kullotat 48
Nga inventarizimi i grumbujve pyjorë të EP Prrenjas dhe nga përpunimi i të dhënave në programin M.Access DB, ka rezultuar panorama e mëposhtme: 48
Ashtu sikurse mund të shikohet, EP Prrenjas ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 7953 ha, ku nga kjo: 48
V.3 Tipet e pyjeve 49
V.4 Tipet e kullotave 51
V.5 Tipet e vegjetacionit potencial 52
V.6 Biodiversiteti 53
V.7 Prania e Vlerave Konservuese të Larta 55
V.8 Rreziku për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin 55
V.9 Mundësitë për aktivitete didaktike dhe kërkimore 55
VI. Analizimi i të dhënave për pyjet dhe kullotat 55
VI.1 Analizimi i të dhënave për pyjet 55
VI.1.1 Analiza e tipeve pyjore 55
VI.1.2 Ndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas regjimit të qeverisjes 62
Ashtu sikure mund të vërehet edhe nga tabela më sipër, dominancën e volumit në ekonomi e mban forma e qeverimit cungishte e cila sigurisht që është në porpocion të drejtë edhe me madhëinë e sipërfaqes. 62
VI.1.3 Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimtarisë së stacionit 62
VI.2 Analizimi i të dhënave për kullotat 65
VI.2.1 Gjendja e kullotave 65
VI.2.2 Madhësia dhe vendndodhja e sipërfaqes kullosore 67
VI.2.3 Altituda, pjerrësia, kundrejtimi dhe kushtet hidrologjike 69
VI.2.4 Mbërritshmëria 70
VI.2.5 Mbledhja e të dhënave për sipërfaqet e djegura në kullota 70
VII. Rezultatet e inventarizimit të pyjeve dhe kullotave 70
VII.1 Rezultati i inventarizimit në pyje 70

VII.1.1 Analiza statistikore e inventarizimit të pyjeve 70
VII.1.2 Volumi në këmbë dhe rritja e grumbujve pyjorë 72
VII.1.3 Struktura vertikale 72
VII.1.4 Cilësia e lëndës drusore në këmbë 74
VII.1.5 Biomasa dhe faktorët e ekspansionit të biomasës (BEF) 74
VII.1.6 Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e Karbonit 75
VII.2 Gjendja shëndetësore/fitosanitare 75
VII.2.1 Drurët e tharë 75
VII.2.2 Dëmtime të tjera 76
VII.3 Prerjet e paligjshme 76
VII.4 Rezultatet e inventarizimit të kullotave 76
VII.4.1 Tipi dhe cilësia e kullotave 76
VII.4.2 Përdoruesit e kullotave dhe koha e përdorimit 78
VII.4.3 Numri aktual i blegtorisë 78
VII.4.4 Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kafshëve 78
VII.4.5 Infrastruktura aktuale 79
VII.4.6 Problemet për kullotjen dhe furnizimin me bazë ushqimore për bagëtitë 79
VIII. Objektivat e planit të mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave 79
VIII.1 Objektivat e përgjithshme për planifikimin afatgjatë 79
VIII.2 Objektivat kombëtare për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave 80
VIII.3 Përputhshmëria me Planifikimin Bashkiak dhe Rajonal 80
VIII.4 Objektivat kryesore të PMPK 80
VIII.5 Objektivat specifikë për ekonominë pyjore 81
VIII.5.1 Objektivat specifikë për tipet pyjore 81
VIII.5.2 Objektivat specifikë silvikulturorë 82
VIII.5.3 Objektivat specifikë për kullotat 83
VIII.5.4 Objektivat specifikë për biodiversitetin 85
VIII.5.5 Objektivat specifikë për gjendjen shëndetësore 86
VIII.5.6 Objektivat specifikë për faunën e egër 86
VIII.5.7 Objektivat specifikë për pyjet me funksion prodhues 86
VIII.5.8 Objektivat specifikë për pyjet me funksion mbrojtës 87
VIII.5.9 Objektivat specifikë për pyjet me funksion rekreativ 87

VIII.5.10 Objektivat specifikë për pyjet me status mbrojtës 87
IX. Masat e planifikimit / aktivitetet në kuadër të PMPK 87
IX.1 Mundësia vjetore e shfrytëzimit 87
IX.2 Prerjet silvikulturore vjetore 89
IX.3 Planifikimi vjetor i masave 90
IX.3.1 Masat në pyje 90
IX.3.2 Masat në kullota 90
IX.3.3 Masat në infrastrukturë dhe në sipërfaqet e degraduara, rekreative dhe didaktike 92
IX.4 Masat afatgjata 92
IX.4.1 Masat silvikulturore në pyjet trungishte 92
IX.4.2 Pyllëzimet dhe ripyllëzimet 93
IX.4.3 Masat e aplikuara në kullota 94
IX.4.4 Gjendja dhe masat në infrastrukturë 96
IX.4.5 Masat specifike për aktivitetet rekreative dhe didaktike 96
X. Vlerësimi ekonomik 97
X.1 Vlerësimi i ndikimeve të masave të planifikuara mbi pyjet dhe kullotat 97
X.2 Planifikimi i të ardhurave / përfitimeve 97
X.3 Planifikimi i shpenzimeve 98
X.4 Analiza shpenzime – përfitim 98
ANEKSI nr. 1: TABELA PËRMBLEDHËSE E EP PRRENJAS 100

A. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbarështimi i pyjeve është planifikimi afatgjatë për fondin pyjor, i cili në rastin konkret është bërë në bazë të kritereve të caktuara për grumbullimin e informacionit për gjendjen faktike dhe përcaktimin e objektivave e masave të nevojshme, në funksion të statusit të dhënë, me synim përmbushjen e funksioneve ekologjike, ekonomike e sociale, duke zbatuar dhe harmonizuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm me nevojat e administruesve, pronarëve privat dhe përdoruesve të tyre. Plani i Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore Prrenjas, synon që të merren në konsideratë të gjithë faktorët që lidhen direkt ose indirekt ndërmjet tyre - popullata lokale, faktorët ekologjik dhe tokësore, administrimi i pyjeve dhe kullotave, ekoturizmi, interesi që ofron pylli, blegtorët etj., pa harruar shërbimet në ekosistem që pylli ofron, të tilla si; kufizimin e erozionit, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ujrave, ruajtjen e natyrës dhe qëndrueshmërinë e resurseve, mbrojtja e tokave bujqësore dhe infrastrukturës etj. Nga ana tjetër pylli përmbush edhe funksione të tjera si; plotësimi i nevojave me material drusor, bazë ushqimore për blegtorinë, si dhe përdorimi i prodhimeve të dyta pyjore përdorimi dhe përftimi i të cilave duhet bërë nëpërmjet një zhvillimi të qëndrueshëm te pyjeve. Mbrojtja e ekosistemeve natyrore, përmiresimi i peisazhit rural dhe mbrojtja e biodiversitetit përbën një drejtim te rëndësishëm të projektit dhe zgjerimi i këtyre zonave do të jetë në qendër të objektivave të veçantë.

Mbarështimi i fundit i EP Prrenjas është kryer në vitin 1985, dhe njohja e gjendjes aktuale të grumbujve është një domosdoshmëri e cila do të marrë përgjigje gjatë trajtimit në këtë plan mbarështimi.

Gjithashtu vend të veçantë zë harmonizimi i interesave të komunitetit dhe të pjesëmarrësve të tjerë veprues në territorin e kësaj ekonomie, në përputhje me mundësine prodhuese aktuale dhe potenciale të pyllit.

Ekonomia pyjore Prrenja shtrihet në territorin e Bashkisë Prrenjas dhe administrohet nga kjo e fundit.

Në total gjatë hartimit të këtij plani mbarështimi, janë gjetur 6169.7 ha më pyje.

Ndërsa referuar formës së qeverimit, fondi pyjor karakterizohet si më poshtë:

- Pyjet trungishte zënë 174.9 ha ose 2.8 % të sipërfaqes pyjore,
- Pyjet cungishte e thjeshtë zene 4724.9 ha ose 76.6 % e siperfaqes pyjore
- Pyje në formën e qeverimit "Cungishte e përbërë:73.6 ha ose 1.2% e sipërfaqes pyjore
- Pyjet shkurre zënë 1196.3 ha ose 19.4 % të sipërfaqes pyjore,


Në formë tabelare dhe grafike, forma e qeverimit e EP Prrenjas paraqitet si në tabelën më poshtë:

a. 1. Tabela forma e qeveriskes

FORMA E QEVERISJES

Forma e qeverisjes	Aktuale Siperfaqja ha	%	E propozuar Siperfaqja ha	%
Ekonomia : EP Prrenjas				
Trungishte	174.9	2.8	174.9	2.8
Cungishte	4724.9	76.6	4724.9	76.6
Trung. e parregullt	0.0	0.0	0.0	0.0
Cung. e perbere	73.6	1.2	73.6	1.2
Shkurre	1196.3	19.4	1196.3	19.4
Livadh	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote me drure	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote me shkurre	0.0	0.0	0.0	0.0
Total:	**6169.7**		**6169.7**	

Ne Total:



Sa i takon funksioneve të evidentuara në këtë ekonomi, gjatë hartimit të këtij plani mbarështimi janë evidentuar 105.6 ha me funksionin mbrojtës, ndërsa në objektivat e planit të ri të mbarështimit të EP Prrenjas janë propozuar për tu shpallur:


- Pyje me funksion proshues 5169.2 ha ose 83.8 % të sipërfaqes pyjore
- Pyjet me funksion mbrojtës+prodhues janë shpallur për herë të parë 409.9 ha pyje ose 6.6% e sipërfaqes pyjore
- Pyjet me funksion mbrojtës 590.6 ha ose 9.6% e totalit të sipërfaqes pyjore


Një panoramë më e plotë në lidhje me funksinet e gjetura dhe ato të dhëna në këtë plan mbarështimi, jepet në tabelën dhe në grafikun më poshtë:


a. 2 Tabela e funksioneve kryesore


FUNKSIONET KRYESORE

Funksioni	Aktuale Siperfaqja ha	%	E propozuar Siperfaqja ha	%
Ekonomia : EP Prrenjas				
Prodhues	6169.7	100.0	5169.2	83.8
Mbrojtes + Prodhues	0.0	0.0	409.9	6.6
Mbrojtes	0.0	0.0	590.6	9.6
Konservim	0.0	0.0	0.0	0.0
Rekreacion	0.0	0.0	0.0	0.0
Total:	**6169.7**		**6169.7**	









Nga inventarizimi i grumbujve të EP Prrenjas, rezulton një volum drusor në këmbë prej 207525 m^3 (meter kub), të vendosura në në sipërfaqe pyjore prej 6169.7 ha, dhe me një volum mesatar

për ha 33.6 m^3/ha. Tabela më poshtë paraqet të dhëna të detajuara për volumin në këmbë, volumin mesatar në korelacion me sipërfaqen.

Regjimi i qeverisjes	**Sipërfaqja (ha)**	**Volumi mesatar (m^3/ha)**	**Volumi i përgjitshëm në këmbë (m^3)**
Trungishte	174.9	101.08	**17678**
Cungishte thjeshtë	4724.9	38.83	**183453**
Cubgishte përbërë	73.6	43.1	**3171**
Shkurre	1196.3	2.7	**3223**
Gjithsej	**6169.7**	**33.6**	**207525**

Ashtu sikurse vërehet nga tabela, volumi kryesor është i përqebdruar në formën e qeverimit cungishte e thjeshtë, me një volum prej 183 453 m^3, i cili në fakt është ne korelacion me sipërfaqen e kësaj forme qeverimi.

Përvecse fondit pyjor në EP Prrenjas është evidentuar një sipërfaqe pyjore prej 986.7 ha. Sipërfaqet kullosore shtrihen thuajse uniformisht në brendësi të territorit të kësaj ekonomie. Sipërfaqet kullosore përbëjnë një aset të çmuar për zonën, pasi nga to sigurohet ushqim për blegtorinë që mbarështohet në zonat rurale të saj.

Për të përmirësuar cilësinë e saj dhe për të rritur kapacitetin mbajtës janë planifikuar që një sipërfaqe prej 347 ha t'i nënshtrohet punimeve përmirësuese të kullotave, e cila presupozon grumbullim të gurëve në breza, heqje e ferrave dhe barërave të këqija dhe në disa raste edhe hedhje fare bari.

Po ashtu janë lanifikuar për t'u ndërtuar tre lera dhe për t'u ripartur dy të tjera.

Infrastruktura rrugore në brendësi të EP, duket në parametra optimalë sa i takon shtrirjes së saj, por cilësia e saj lë për të dëshiruar. Infrastruktura rrugore eksistuese duhet t'i nënshtrohet një mirëmbajtje të vazhdueshme nga ana e pushtetit vendor, pasi ajo [ërbën një element të rëndësishëm për lidhjen e zonave rurale në brendësi të ekonomisë, me qendrën e qytetit, nga ku presupozohet që banorëve t'u ofrohen shërbime cilësore, por njëkohësisht edhe sipërfaqeve pyjore t'u shërbehet më mirë.

I. Hyrje

I.1 Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave

Qëllimi kryesor i hartimit të një plani mbarështimi është njohja e gjendjes reale të grumbujve pyjorë, e formave të përdorimit të tokës dhe gjendja social-ekonomike në konturin territorial administraiv të EP Prrenjas.

Ky plan mbarështrimi për ekonominë pyjore Prrenjas, bëhet i mundur në sajë të financimit, të mundësuar nga buxheti i Bashkisë Prrenjas.

Njohja e gjendjes së pyjeve, përcaktimi dhe vlerësimi aktual dhe në perspektivë i potencialit prodhues dhe i mjaft funksioneve të tjera që ofron pylli, arrihet nëpërmjet mbarështrimeve periodike (çdo 10 vjet). I njohur si element i domosdoshëm për të përcaktuar qartë se si është gjendja aktuale e pyllit, ku duam t'a shpiem atë. Mbarështrimi paraqet rëndësinë e tij të pa zëvendësueshme dhe bëhet bashkëudhetar jetik i pyjeve të trajtuar, në vecanti. Për këtë qëllim, duke parë edhe kohën e gjatë që ka kaluar si dhe ndryshimet drastike që kanë pësuar sipërfaqet pyjore të vendit tonë gjatë kësaj periudhe (të ashtuquajtur tranzicion) u bë i domosdoshëm edhe mbarështrimi i ekonomisë pyjore "Prrenjas.

Ekonomia pyjore "Prrenjas", është mbarështruar për herë të fundit në vitin 1985. Mbarështrimi i saj është mundësuar nga stafi teknik i ish Ndërmarrjes Pyjore të rrethit Librazhd. Që nga ajo kohë e deri më sot kanë kaluar afro 40 vjet, në të cilat kjo ekonomi pyjore, ka pësuar ndryshime të mëdha dhe mjaft të ndjeshme, si përsa i përket strukturës ashtu dhe shpërndarjes së vëllimit sipas klasave të moshës dhe prodhimit. Prandaj duke u nisur nga këto arsye dhe, njëkohësisht duke vlerësuar punën e bërë për hartimin e planit të pararendës, u pa e arsyeshme dhe e domosdoshme hartimi i këtij plani të ri mbarështrimi, i cili pasqyron gjëndjen reale të grumbujve, duke i parë në këndvështrime të ndryshme si ajo e prodhimtarisë, e ruajtjes së biodiversitetit dhe garantimin e periodicitetit ciklik të qëndrueshëm të vjeljes së materialeve drusore dhe të mirave që ofron pylli.

Plani i Mbarështrimit të kësaj ekonomie është hartuar në ***Udhëzuesin e Planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të vitit 2019*, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 834.**
Ndërsa përpunimi i të dhënave është bërë sipas programit të punimeve të zyrës (Microsoft Accsses Database) të hartuar me ndihmën e FAO dhe miratuar nga ish D.P.P.K.

Objektivat e mbarështrimit janë hartuar e ideuar në bashkëpunim me stafin e specilaistëve të Shërbimit Pyjor pranë Bashkisë Prrenjas, popullatat lokale dhe me organet e Pushtetit Vendor. Ato kanë konsistuar në:

- Arritjen e normalitetit të grumbujve pyjorë, me qëllim garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm për të dhënë një prodhim maksimal duke siguruar një nivel të lartë të të ardhurash dhe nivel të lartë funksionimi të ekosistemit pyjor.
- Sigurimi i shumëfunksionalitetit të pyllit për ruajtjen e biodiversitetit dhe shtimit të të ardhurave në dobi të popullatave lokale të zonës ku shtrihet ekonomia pyjore Prrenjas.
- Intensifikimi i rritjes natyrore të grumbujve, nëpërmjet ndërhyrjeve silvikulturale, sidomos në cungishtet e degraduara të kësaj ekonomie, duke synuar në të njëjtën kohë edhe përmirësimin e strukturës së klasave të moshës.
- Shtimi i sipërfaqes së mbulesës pyjore dhe sigurimi i vazhdimësisë së ripërtëritjes natyrore.
- Përmirësimi i strukturës llojore dhe dhënia prioritet llojeve natyrore që arrijnë të fitojne maksimumin e potencialit ekologjik të zonës.
- Përmirësim i mëtejshëm i shërbimit me rrugë auto të ekonomisë nëpërmjet meremetimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit rrugor aktual dhe hapjes se segmenteve të rinj aty ku është i nevojshëm, me qëllim shërbimin në kohë e me cilësi të nevojave që paraqet pylli, dhe në të njëjtën kohë për qëllime rekreative e shumë funksionale.

Në këtë plan mbarështrimi një vëmendje e veçantë i është kushtuar politikave te planifikimit, për të patur një mbarështrimi të qëndrueshëm dhe shumë funksional të pyllit. Është synuar të arrihet realisht potenciali prodhues i pyjeve duke mbrojtur biodiversitetin dhe mjedisin në tërësi.

I.2 Ecuria e punës dhe përgjegjësitë

Pas firmosjes se kontrates me bashkinë Prrenjas, puna filloi me grumbullimin e dokumentave te nevojshem per hartimin e planit te mbareshtrimit si: planin e vjeter te inventarizimit, hartat e ekonomise pyjore, studimet e meparshme si: Plani i zhvillimit Vendor i Bashkise Prrenjas dhe dokumentat qe lidhen me aspektin ligjor ne fushen e pyjeve të tilla si kontratat aktuale të qirasë mbi territorin e Bashkisë Prrenjas apo aktivitete të ligjshme ekonomike në këtë ekonomi.
Pergjegjesia per kryerjene punimeve te terrenit dhe hartimin e planit te mbareshtrimit ka qene e kompanise **Lurimi shpk**. Eksperti GIS pasi ndertoi harten pyjore te ngastrave dhe nengastrave pyjore ndertoi rrjetin e siperfaqeve prove i cili u pasqyrua ne harte dhe ne ortofoto dhe me pas pikat e ketij rrjeti u hodhen ne GPS ku me pas filloi puna e terrenit e cila zgjati per nje periudhe 10 ditore. Pas perfundimit te matjeve ne terren puna vazhdoi me perpunimin e te dhenave dhe me shkrimin e raportit te planit te mbareshtrimit.

Pas mbledhjes së materiale përgatitore, në ambjentet e Bashkise Prrenjas u organizuan takime me stafin përgjegjës për pyjet përgjatë muajve Korrik dhe Gusht 2025 ne njesite administrative ku dhe shtrihen ekonomite pyjore qe janë marrë në studim**.** Një nga avantazhet kryesore ishte aftësimi i stafit në përdorimin e pajisjeve per inventarizim te siperfaqeve prove. Punimet e terrenit

do te pasqyrohen ne fletet e terrenit te percaktuara keto ne udhezuesit perkates te hartimit te planeve te mbareshtimit dhe me tej ne perpunimin e te dhenave sipas pikave prove. Ky organizim dhe nje indikacion të vlefshme në lidhje me mundësitë dhe sfidat për një përvetësim sa më të mirë te te dhenave dhe rezultateve midis anëtarëve të stafit ndihmes të konsulentit Lurimi.

Me dt.04.08.2025 eshte zhvilluar takimi hapes i PM per ekonomine pyjore Prrenjas, ne njesite administrative Qukes dhe Rrajce dhe ne fshatrat ku dhe shtrihet ekonomia pyjore.

Takimet kanë vazhduar në muajn Gusht 2025 nëpër fshatrat e Njesise Administrative ku dhe shtrihet ekonomia pyjore.

Ne takime është diskutuar me grupet e interesit lidhur me mundesine e nje menaxhimi me te mire dhe tradicional (sipas banoreve) te pyjeve te zones.

Kerkesat dhe sygjerimet me shume ishin ne drejtim te prodhimit te druve te zjarrit pasi zonat jane shume te ftohta ne stinen e dimrit dhe nevojat jane shume emergjente dhe per ndertimin e lerave te bagetive si shume te domosdoshme.

Banoret kerkuan me tej lidhur me ushqimin e blektorise ne keto zona, ndertimin e disa lerave per bagetite dhe riparimi i asaje ekzistuese dhe ndertimin e disa koritave per une neper burimet aktuale qe jane ne kete ekonomi pyjore.

Kerkesa ishte me shume per trajtimin e siperfaqeve pyjore afer banesave qe kishte te bente me prodhimin e drve te zjarrit per nje trajtim tradicional te pyjeve ne afersi te banoreve te zones.

Më poshtë po ilustrojmë me foto takimet me përfaqësues të bashkisë Prrenjas dhe banorëve të zonës ku shtrihet kjo ekonomi.








Gjatë diskutimeve janë mbajtur në konsideratë të gjitha sugjerimet e bëra si nga administrata përgjegjëse për pyjet në bashki, por edhe nga banorët që jëtojnë në brendësi të EP Prrenjas.

Këto sugjerime do të jenë pjesë e objektivave të këtij plani dhe masave që do të propozohen për zbatim gjatë afateve ligjore prej 10 vitesh.

I.3 Metodologjia e punës

U zbatua një metodologji nëpërputhje të plotë me përshkrimet në *Udhëzuesin e Planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të vitit 2019*, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 834.

Fillimisht, me ngritjen e grupeve të punës së terrenit është vijuar me trainimin e tyre si për përdorimin e pajisjeve ashtu edhe për procedurat që kryhen në sipërfaqe provë, duke përfshirë elementët e gjetjes së qendrës së sipërfaqes provë, materializimin e saj me shufër hekuri dhe matjet që kryhen në sipërfaqet provë në funksion të gjendjes së grumbullit të gjetur në terren.

Fi**LLIMI I TRAJNIMIT PER PAJISJET LOGJISTIKE DHE VENDOSJEN E SIPËRFAQEVE PROVË.**

Trajnimi per perdorimin e pajisjeve logjistike :






Pas trajnimit ne zyre, **puna vazhdoi me trajnimin ne terren** ku aspektet metodologjike te inventarizimit dhe instrumentat kryesore dendrometrike kane qene ne fokus te trajnimit ne terren me grupet e punes.





Materializimi I sipërfaqes provë në terren.

Një nga avantazhet kryesore ishte aftësimi i stafit në përdorimin e pajisjeve per inventarizim te siperfaqeve prove. Punimet e terrenit do te pasqyrohen ne fletet e terrenit te percaktuara keto ne udhezuesit perkates te hartimit te planeve te mbareshtimit dhe me tej ne perpunimin e te dhenave sipas pikave prove. Ky organizim dhe nje indikacion të vlefshme në lidhje me mundësitë dhe sfidat për një përvtësim sa më të mirë te te dhenave dhe rezultateve midis anëtarëve të stafit ndihmes të konsulentit Lurimi.

Është thelbësore që të lidhet analiza e burimeve pyjore dhe kullosore me vizionin lokal të shprehur përmes takimeve me palët e interesuara. Qëllimi është gjetja e ekuilibrit të duhur midis kapaciteteve të burimeve pyjore-kullosore dhe pritshmërive të përdoruesve, në përputhje me rregulloret për një mbarështim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional.

Ndërtimi i hartave të punës në terren nga eksperti i GIS, shërbeu si pikë nisje për inventarizimin e grumbullit në terren. Punimet e terrenit janë mbështetur në Udhëzuesin e miratuar për këtë qëllim. Kështu, pas gjetjes së pikës nëpërmjet pajisjes GPS, është materializuar qendra e sipërfaqes provë (SP) me një shufër hekuri me ϕ= 10 mm dhe gjatësi 250 mm. Qendra e SP është referuar në objekte të tjera të qëndrushme, për lehtësi të identifikimit në çdo kohë, duke përdorur bojë dhe duke dhënë distancat reale të shenjës nga qendra.

Më pas, janë hedhur të dhënat identifikuese në skeden e invenatarizimit të SP dhe ka filluar puna për matjet. Në funksion të gjendjes së SP, matjet janë mbështetur në sipërfaqe provë bashkëkoncentrike me madhësi: 25 m^2, 200 m^2 dhe 400 m^2.
Për çdo dru është matur diametri në lartësinë e gjoksit (1.3 m nga toka) dhe në çdo katër drurë është matur lartësia e drurit përkatës. Numërimi i drurëve dhe matjet përkatëse kanë filluar prej drurit të pozicionuar në 0° shmangie nga poli i Veriut, duke u rrotulluar në sensin orar nga qendra e SP.
Pas përfundimit të matjeve, është kontrolluar skeda për ndonjë mangësi dhe ka vijuar më tej puna për matjet në terren.
Gjatë lëvizjes në terren, janë kryer edhe përshkrimet parcelare për secilën njësi unike të krijuar (nënparcelë), duke marrë të dhëna direkte bazuar në situatën aktuale të terrenit.
Gjatë kryerje së punimeve te terrenit, ekipi i kompanise Lurimi ka patur kontakte te vazhdueshme me stafin e pyjeve te bashkise Prrenjas si dhe me banorët e Njësive Administrative që ndodhen në brendësi të EP Prrenjas. Gjatë takimeve janë shkëmbyer mendime dhe jane informuar banorët për punën e kryer në vijimësi.

I.4 Informacioni i përdorur në përgatitjen e PMPK

Krahas informacionit të mbledhur gjatë inventarizimit në terren dhe procesit me pjesmarrje, informacioni specifik që ishte i domosdoshëm të sigurohej në nivelin e Bashkisë Prrenjas në fillim të aktiviteteve ishte:

- Ndarjet parcelare dhe n/parcelare për EP Prrenjas sipas kadastrës dhe AlFIS;
- Plani i mëparshëmi i Inventarizimit te EP Prrenjas
- Te dhena demografike sipas fshatrave brenda territorit te ekonomise pyjore
- Aktivitete të lidhura me prodhimet drusore dhe jodrusore nga pyjet dhe kullotat;
- Rrugët dhe infrastruktura pyjore;
- Të dhëna historike mbi zjarret në pyje dhe rreziqet natyrore (rrëshqitjet e tokës, përmbytjet, stuhitë, tharjet e drurëve);
- Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë;
- Prania e aktiviteteve edukative dhe didaktike lidhur me pyjet dhe kullotat;
- Prania e aktiviteteve turistike lidhur me pyjet dhe kullotat;
- Prania e siteve me vlera të larta mbrojtjeje. Kjo përfshin rezervatet farore, habitatet e veçanta (liqene, pyje të brigjeve të lumenjve...), site të njohura për vlerat kulturore, peizazhe të mbrojtura.;
- Prania e aktiviteteve kërkimore në pyje dhe kullota.

II. Përshkrim i përgjithshëm i bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore Prrenjas.

II.1 Informacion i përgjithshëm rreth Bashkisë dhe ekonomisë pyjore

EP Prrenjas, është pjesë territoriale admministrative e bashkisë Prrenjas. Ajo bën pjesë në basenet ujëmbledhës të lumit Shkumbin. Ndërsa sa i takon baseneve më të vogla, ajo përfshin në brendësinë e saj basenin e përroit të Bushricës, Dingonjës, pproi i Valës dhe Gurit të Zi.
Emërtimi i saj vjen nga vetë emri i qytetit të Prrenjasit, pasi vetë ekonomia e rrethon dhe e mban në qendër qytezën e Prrenjasit.
Planet e mbarështrimit dhe të inventarizimit të mëparshëm për këtë ekonomi pyjore, kanë patur po këtë emër.
Ekonomia pyjore kufizon me ekonominë pyjore:
Në veri: EP Rajcë dhe Ekonominë Pyjore Shebenik Jabllanicë;
Në Perëndim: EP Vehçan, EP Dardhë Xhyrë dhe EP Turje;
Ndërsa në Liondje e Jug EP Prrenjas kufizon me kufirin territorial administrative të Bashkisë Pogradec.
EP Prrenjas shtrihet ndërmjet gjatësisë gjeografike 41°16′20″ dhe gjërësi gjeografike 41°15′30″ – 41°00'00''.
Ajo është pjesë e hartave topografike me shkallën 1:25000

1. K – 34 – 101 – B – a (Mali i Quksit)
2. K – 34 – 101 – D – b (Qukës - Skënderbej)
3. K – 34 – 101– D – d (Berzezhdë)
4. K – 34 – 102 – C – d (Rajcë)
5. K – 34 – 102 – C – c (Prrenjas)

Sa i takon shtrirjes në kufijtë natyrorë, EP Prrenjas fillon në kuotën 1481m zbret në kuotën 1420 m, vazhdon përgjatë kuotës 1120, zbret në kuotën 1072.6 m, vazhdon përgjatë kurrizit deri në kuotën 1072 m, më pas 1064 m, vazhdon përgjatë rrugës auto Rodovol, më pas vazhdon përgjatë përroit që del në kuotën 486 m, vazhdon përgjatë rrugës së Stravajt, del në kuotën 696.7 m, vazhdon përgjatë përroit të Radicinës dhe mbyllët në Cepin e Buallit në kuotën 811 m.
Sipërfaqja e përgjithshme e Ekonomisë Pyjore Prrenjas mbështetur në planin e inventarizimit të vitit 1985, në të gjithë konturin e saj është 17 282.2 ha, ku nga kjo:

- **I. Sipërfaqe pyjore gjithsej: 6270.7 ha e ndarë në:**
- A. Trungishte 1070, 95 ha
- B. Cungishte 2551.25 ha
- C. Shkurre 2654.5 ha
- **II. Sipërfaqe jo pyjore gjithsej:**
- A. Kullota dhe livadhe 1883.6 ha
- B. Sipërfaqe Djerr (e zhveshur) 320.85 ha
- C. Sipërfaqe joproduktive 959.3 ha
- D. Toka bujqësore dhe troje 7941.75 ha

Sa i takon të dhënave të bashkisë e cila administron këtët ekonomi pyjore theksojmë se ajo është bashkia Prrenjas.

Bashkia Prrenjas është pjesë e Qarkut të Elbasanit. Ajo kufizohet me Bashkinë Librazhd dhe Pogradec.

Bashkia Prrenjas përmbledh në konturin e saj territorial administrativ një sipërfaqe të përgjithshme prej 322.95 km^2. Qendra e Bashkisë është qyteti i Prrenjasit. Ajo ka një popullsi prej 24 906 banorë sipas censusit, ndërsa në regjistrin civil ajo ka 33 031 banorë.

Ajo ka 4 Njësi Administrative në përbërjen e saj:

1. Nj. A Prrenjas, e cila në përbërje të saj ka Qytetin Prrenjas dhe fshatrat Prrenjas-Fshat dhe Rrashtan
2. Nj.A Qukës, me fshatrat Qukës Shkumbin, Qukës Skënderbej, Skroskë, Mënik, Gurrë, Bërzheshtë, Fanjë, Karkavec, Dritaj, Pishkash dhe Pishkash Veri
3. Nj. Rrajcë me fshatrat Rrajcë, Sutaj, Skënderbej, Bardhaj, Katjet, Kotodesh dhe Urakë.
4. Stravaj me fshatrat Stravaj, Stranik, Farret, Shqiponjë dhe Sopot.




Figura II.1 Teritori i bashkisë Prrenjas, me Njësitë Admnistrative

PROFILI I BASHKISË

Zona Gjeografike: Përrenjasi kufizohet në veri me bashkinë Librazhd, në lindje me Republikën e Maqedonisë, në jug me Bashkinë Pogradec dhe në perëndim me Bashkinë Elbasan. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Përrenjasit.

Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2011, Përrenjasi ka një popullsi prej 24,906 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki ka 33,031 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 322.95 km^2. Sipas censusit, densiteti i popullsisë është 77 banorë/km^2 ndërsa sipas regjistrit civil densiteti është 102.279 banorë/km^2.

Të dhëna të tjera: Bashkia e Përrenjasit përfshin sipërfaqe të shumta pyjore dhe burime të bollshme hidrike si dhe një fushë pjellore. Nëntoka është e pasur me krom, ndërkohë që ky mineral shfrytëzohet aktualisht në dy prej fshatrave të bashkisë së re.

Zonat e Rrajcës, Qukësit dhe Stravajt kanë sipërfaqen më të madhe të pyjeve në këtë zonë. Megjithatë, shfrytëzimi pa kriter gjatë dy dekadave të fundit i ka dëmtuar pyjet në një masë të gjerë.
Bashkia e Përrenjasit ka një pozicion të favorshëm gjeografik, pasi gjendet fare pranë dy pikave doganore me Maqedoninë. Përgjatë tranzicionit, në këtë zonë kanë munguar strategjitë e zhvillimit. E megjithatë, emigracioni në zonën e Përrenjasit nuk ka qenë i lartë. Kjo pasi shumë banorë të zonës kanë zgjedhur punësimin sezonal në Maqedoninë fqinje, me të ardhurat e të cilëve mbijeton një pjesë e mirë e popullatës.Bashkia e Përrenjasit ka potenciale të pashfrytëzuara për turizëm natyror. Me historinë e pasur të zonës së Rrajcës, ku ndodhet shkëmbi i Skënderbeut dhe legjenda për Sofrën e tij si dhe me bukuritë natyrore të Sopotit, zona mund të kthehej në një destinacion për vizitorë vendas dhe të huaj.

II.2 Pronësia, administrimi dhe organizimi

Ekonomia Pyjore Prrenjas, administrohet nga Bashkia Prrenjas, nëpërmjet Srukturës Përgjegjëse për pyjet e cila është e inkuadruar brenda Drejtorisë së Bujqësisë, Ujërave, Pyjeve dhe Turizmit. Pronësia e kësaj ekonomie është 100% publike dhe administrohet nga nga bashkia me të njëjtin emër.
Struktura përgjegjëse për pyjet është e organizuar në dy Sektorë, ku njëri është përgjegjës për menaxhimin e sipërfaqes pyjore dhe tjetri është përgjegjës për ruajtjen dhe kontrollin e sipërfaqeve pyjore nën administraimin e kësaj bashkie.
Vetë ekonomia pyjore Prrenjas rrethon qytetin dhe qendrën e bashkisë Prrenjas. Distanca më e largët nga qendra e qytetit është 12.7 km.
Duke qenë se ekonomia ka në brendësi të saj një numër të konsiderueshëm qendrash të banuara, lidhja e saj me qendrën e qytetit përbëhet nga një rrjet rrugur mjaft i dendur dhe i mirëmbajtur.


Pavërësisht pronësisë, administrimi i pyjeve dhe kullotave bëhet në përputhje me ligjin 57/2020, "Për pyjet" dhe ligjin 8963, "Për fondin kullosor".

Organizimi mbi të cilën ndodhet edhe sipërfaqja pyje dhe kullota të EP Prrenjas, i referohet dhe i takon konturit territorial administrativ të Bashkisë Prrenjas. Struktura Përgjegjëse për Pyjet pranë kësaj bashkie e vendosur në Drejtorinë e Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit është përgjegjëse për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor në konturin territorial dhe adinistrativ të kësaj bashkie.

Pjesa më e madhe e kësaj EP, është në pronësi publike, ndërsa në brendësi të saj por edhe në afërsi të saj ajo karakterizohet nga një sipërfae e konsiderueshme tokash bujqësore dhe traje e zona urbane, të cilat nuk do të jenë pjesë e konturit të kësaj ekonomie në këtë plan mbarështimi. Një panoramë e përgjithshme e ekonomisë jepët në tabelën në vijim:

PERDORIMI I TERITORIT

Perd.teritorit	Aktuale Siperfaqja ha	E propozuar Siperfaqja ha
Ekonomia : EP Prrenjas		
Bashkiake		
Pyll	6147.6	6300.0
Sip.me bim. pyjore	477.6	346.3
Bujqesi	0.0	0.0
Kullote, Livadh	986.7	986.7
Urbane	0.0	0.0
Ujore	0.0	0.0
Kenete, Mocal	0.0	0.0
Djerr	36.9	18.7
Joproduktive	304.1	301.2
Total:	**7952.9**	**7952.9**
Total		
Pyll	6147.6	6300.0
Sip.me bim. pyjore	477.6	346.3
Bujqesi	0.0	0.0
Kullote, Livadh	986.7	986.7
Urbane	0.0	0.0
Ujore	0.0	0.0
Kenete, Mocal	0.0	0.0
Djerr	36.9	18.7
Joproduktive	304.1	301.2
Total:	**7952.9**	**7952.9**



II.3 Vendndodhja gjeografike dhe administrative

EP Prrenjas, është pjesë territoriale admministrative e bashkisë Prrenjas. EP Prrenjas shtrihet ndërmjet gjatësisë gjeografike 41°16′20″ dhe gjërësi gjeografike 41°15′30″ – 41°00'00''.
Ajo është pjesë e hartave topografike me shkallën 1:25000

1. K – 34 – 101 – B – a (Mali i Quksit)
2. K – 34 – 101 – D – b (Qukës - Skënderbej)
3. K – 34 – 101– D – d (Berzezhdë)
4. K – 34 – 102 – C – d (Rajcë)
5. K – 34 – 102 – C – c (Prrenjas)

Sa i takon shtrirjes në kufijtë natyrorë, EP Prrenjas fillon në kuotën 1481m zbret në kuotën 1420 m, vazhdon përgjatë kuotës 1120, zbret në kuotën 1072.6 m, vazhdon përgjatë kurrizit deri në kuotën 1072 m, më pas 1064 m, vazhdon përgjatë rrugës auto Rodovol, më pas vazhdon përgjatë përroit që del në kuotën 486 m, vazhdon përgjatë rrugës së Stravajt, del në kuotën 696.7 m, vazhdon përgjatë përroit të Radicinës dhe mbyllët në Cepin e Buallit në kuotën 811 m.

II.4 Konteksti i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore

Ekonomia Pyjore Prrenjas është si një mburojë e qytetit me të njëjtin emër, duke e përfshirë atë në brendësi të saj dhe thuajse në qendër.

Qendra e bashkisë ndodhet në qytetin e Prrenjasit. Emri i Prrenjasit, ka lidhje me luftërat e përgjakshme shqiptaro-turke.

Ne periudhën e luftërave shqiptaro-turke fusha ku ngrihet qyteti i Përrenjasit quhej fusha e Torviollit. Skënderbeu, heroi ynë kombëtar, para se te nisej ne beteje (beteje e cila ne histori

njihet si beteja e Torviollit) kundër turqve porosit luftëtaret e tij, duke u thëne se këtë beteje duhet ta fitojnë me domosdo, nga ku me vone fusha e Torviollit u njoh me emrin "Fusha e Domosdoves".

Edhe emri i qytetit te Përrenjasit ka lidhje pikërisht me te njëjtën beteje, te cilën Skënderbeu e fitoi por pati humbje te mëdha ne njerëz si nga pala turke ashtu dhe nga ajo shqiptare. Nga gojëdhënat thuhet se janë vrare aq shume luftëtare sa gjaku i tyre rridhte si përrenj. Pikërisht nga kjo gojëdhëne, pas luftës nacionale çlirimtare, kur u krijua ky qytet vendosen te quhet Përrenjas.

Fusha e Domosdoves dhe zonat përreth saj kane pasuri te shumta minerare e për këtë fakt u vendos qe ne këtë zone te ndërroheshe qyteti i ri i Përrenjasit.

Qyteti i Prrenjasit ka pasuri te shumta minerare e ne baze te tyre janë ngritur miniera për përpunimin e tyre si ajo e hekur-nikelit ne Perrenjas-Fshat, Miniera e Nikel-Silikatit ne Pishkash,e Sektori Minerar i Bushtricës dhe Skroskes.

Ne fillim te viteve '90 është zhvilluar dhe sektori privat ne te cilën rendësi te madhe kane bizneset e vogla kryesisht ne sektorin e shërbimeve, blegtori, bujqësi gjithashtu dhe ne shfrytëzimin e pyjeve.

Popullsia qe u vendos ne qytetin e Përrenjasit ne fillimet e tij përbehej me se shumti nga banore te erdhur nga rrethet jug-lindore te Shqipërisë. Ne fillim te viteve '90 filloi një fluks shpërnguljesh masive nga zonat rurale drejt qytetit e cila vazhdon dhe ne ditët e sotme duke rritur gjithnjë e me tepër popullsinë dhe si rrjedhim sipërfaqen e qytetit.

Ndërsa vetë ekonomia pyjore e marrë në studim, ka të njëjtin emër si dhe vetë qyteti dhe zona: Prrenjas.

II.5 Historiku i mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave në Ekonominë Pyjore

Ekononima pyjore Prrenjas, është mbarështruar për herë të fundit në vitin 1985. Nga të dhënat e planit të vjetër të mbarështrimit, bie në sy fakti që vetëm 34.2 ha ose 0.5% e totalit të ekonomisë kanë patur funksion mbrojtës dhe pjesa tjetër prej 99.45% ka patur funksion prodhues.

Në përgjithësi, ekonomia pyjore Prrenjas, ka shërbyer për sigurimin e lëndës drusore, si për lëndë punimi ashtu edhe për dru zjarri. Është karakterizuar, nga një prodhimtari e lartë dhe sigurim të lëndës drusore, kryesisht dru zjarri dhe kryesisht lënda e siguruar nga shfrytëzimi i makies dhe dushqeve. Sipas planit të mbarështrimit të vitit 1985, Ekonomia Pyjore Prrenjas, rezulton me një sipërfaqe të përgjithshme prej 17 282.2 ha, e cila

I. Sipërfaqe pyjore gjithsej: 6270.7 ha e ndarë në:

- A. Trungishte 1070, 95 ha
- B. Cungishte 2551.25 ha
- C. Shkurre 2654.5 ha
- **II. Sipërfaqe jo pyjore gjithsej:**
- A. Kullota dhe livadhe 1883.6 ha
- B. Sipërfaqe Djerr (e zhveshur) 320.85 ha
- C. Sipërfaqe joproduktive 959.3 ha
- D. Toka bujqësore dhe troje 7941.75 ha

Nga të dhënat e mbarështrimit të vitit 1985, ekonomia pyjore Prrenjas, rezulton me 94 677 m^3, lëndë drusore në total, ku nga kjo 43 129 m^3, vijnë nga trungishtet, 26 0476 m^3 nga cungishtet dhe një volum prej 25 501 m^3vjen nga shkurret e kësaj ekonomie.

Në kuadër të shfrytëzimeve të kryera, pavarësisht se në të gjithë ekonominë nuk ka patur asnjë metër katror me funksion mbrojtës, janë respektuar rregullat e shfrytëzimit në sipërfaqe me pjerrësi të madhe mbi 70 %.

Pas vitit 1990, vit i cili përkon me prishjen e sistemit shtetëror të centralizuar dhe kalimit në ekonominë e tregut, shfrytëzimi i pyjeve është kryer nga subjektet private të liçensuara për këtë qëllim. Pavarësisht se sasia e materialit drusor nuk ka qenë e shumtë shfrytëzimet kanë vijuar, kryesisht për sigurimin e druve të zjarrit nga banorët vendas. Dëme të konsiderueshme kjo ekonomi pyjore ka patur gjatë vitit 1997, deri në vitin 1999, kohë e cila përkon me daljen jashtë funksionimit të shumë institucioneve. E gjithë pjesa e mbritur me rrugë auto e ekonomisë, është zhdukur e prerë rrah totalisht gjatë këtyre viteve, por në sajë të kujdesjes të stafit, aktualisht kjo pjesë e ekonomisë është rimëkëmbur, dhe aktualisht është në gjendje të mirë.

Planifikimi 10-vjecar, i planifikuar në planin e mbarështrimit të vitit 1985, nuk është realizuar ose është shkelur cdo parim i tij. Janë kryer disa investime të vogla, me fondet e ish projektit të pyjeve të cilat kanë patur impakt në përmirësimin e cungishteve, kryesisht në pjesët e ulëta të ekonomisë, e disa të tjera rreth zonave të banuara.

II.6 Situata demografike dhe socio-ekonomike

Demografia

Ekonomia Pyjore "Prrenjas" përbëhet nga komunitete lokale të cilat janë pjesë e Bashkisë Prrenjas, Njësisë Administrative Qukës, Rrajcë dhe Stravaj. Në territorin e EP Prrenjas dhe në kufij

të saj jetojnë 11 200 familje në total. Numri i total i banorëve që jetojnë në afërsi dhe brendësi të Ekonomisë Pyjore Prrenjas është 33 256. Të dhëna më të detajuara jepen në tabelën më poshtë:

NJ.Q.V	**Familje**	**Banorë**	**Meshkuj**	**Femra**
Bashkia Prrenjas	2984	8817	4452	4365
Nj.A Qukës	3528	10481	5778	5003
Nj.A Rrajcë	3726	11215	5884	5331
Nj.A Stravaj	962	2743	1448	1295

Me gjithëse një pjesë e konsiderueshme e famijeve e kanë të lidhur jetesën e tyre me punë që nuk lidhen me resurset e ekonomisë, kontributi i kësaj të fundit është i padiskutueshëm si në ofrimin e të mirave për banorët ashtu dhe në rritjen e cilësisë së jetesës për to. Me përjashtim të kullotjes dhe rasteve të rralla të sigurimit të druve të zjarrit, në sipërfaqene e EP Prrenjas nuk ka presion human të ndonjë dimensioni tjetër.

Toka bujqësore, të dhëna të përgjithshme

Bashkia Prrenjas ka një siperfaqe të përgjithshme prej 322.95 km. katrore, nga të cilat toka bujqësore zë një siperfaqe prej 6086 ha. nga kjo, vetëm 3892 ha janë të ndara me ligjin 7501, ndërsa pjesa tjetër prej 2194 ha janë toka të pandara ose te refuzuara.

Ne kategorine "Toka te refuzuara" shume fermere i posedojne keto toka duke ushtruar aktivitet bujqesor por mungesa e dokumentacionit i pengon ata per te bere investime afatgjata.

Eshte e nevojshme qe te behet nje inventarizim i plote i ketyre siperfaqeve per te adresuar me shifra gjithe problematiken ,duke permiresuar hartografine dhe librat kadastrale.

Ndarja e tokës bujqësore sipas ligjit 7501"Për token" krijoi një situatë të pa favorshme për përdorimin e tokës, ndërsa shfrytëzimi i saj me efektivitet u vështirësua së tepërmi,pasi copëtimi i skajshëm i parcelave, uli në mënyrë drastike efektivitetin e punës,rriti shpenzimet,vështirësoi komunikimin në parcelë etje. Bashkia Prrenjas në 01.08.1991 ka pasur 5419 familje fermere dhe toka është e ndarë dhe e fragmentuar në me teper se 30.000 ngastra.

Rendimentet e kulturave të drithrave në vite pësuan një rënie të ndjeshme dhe sot për grurin kemi një rendiment mesatar 29 kv/ha dhe 42 kv/ha në kulturën misër, ndërsa kulturat e tjera si pemët perimet,rrushi etje, kanë marrë një rëndësi te veçantë në strukturën e mbjelljeve.

Reformat e qeverisë lidhur me subvencionet e ndryshme kanë filluar të japin frytet e veta, ku nga viti ne vit është rritur dukshëm interesi i fermerëve,për të aplikuar në skemën e naftës pa akcizë për bujqësinë.Lehtësimi i kësaj skeme, duke i motivuar fermerët për të aplikuar edhe ne grupe(koperim), është një mbështetje e fuqishme që ju bëhet sidomos kategorisë së fermerëve

që kanë pak sipërfaqe toke (qe nuk plotesojne kriterin 1 ha).Nëpërmjet kësaj skeme fermerët mund të bashkojnë parcelat kufitare për të krijuar një koperim nëpërmjet një kontrate të thjeshtë ,që legalizohet pranë njësive të qeverisjes vendore pa pasur nevojë të paraqiten tek noteri.

Reforma e tokës megjithë vështirësitë që ka për implementimin e saj të plotë, ka dhënë frytet e saj tek personat e apasionuar me tokën, të cilët kanë krjiuar ferma me pemë frutore, me vreshta, parqe bletësh etje. Pothuajse të gjithë këta fermerë kanë aplikuar dhe fituar projekte nga AZHBR, sektor ky në te cilin përveç përfitimit të drejtpërdrejtë janë përfituar edhe subvencione.

Ne menyre te permbledhur siperaqja e sipas përdorimit të tokes ne Bashkine Prrenjas paraqitet ne tabelen e meposhtme:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	**Siperfaqja e tokes bujqesore gjithsej**	**Ha**	**6086**
1/1	Toke bujqesore ndare me 7501 Bashkia	Ha	**3892**
A	Njesia Administrative Rrajce	Ha	1421
B	Njesia Administrative Prrenjas	Ha	451
C	Njesia Administrative Qukes	Ha	1440
D	Njesia Administrative Stravaj	Ha	580
1/2	**Toke e pa ndare Bashkia**	**Ha**	**2194**
A	Njesia Administrative Rrajce	ha	321
B	Njesia Administrative Prrenjas	ha	118
C	Njesia Administrative Qukes	ha	1441
D	Njesia Administrative Stravaj	ha	314
2	Familjet perfituese ne 01.08.91	Nr	4924
3	**Toke pyjore gjithsej**	**Ha**	**18399.9**
A	Pyje	Ha	15794.04
B	Kullota	Ha	1841.32
C	Shkembore	Ha	764.4

Nga sa më sipër cituam, me synimin për të bërë një kthesë në drejtim të rritjes së interesit të fermerëvë për bujqësinë si dhe të mbështetjes së fermerëve me investime rekomandojmë:

- Përqëndrimi i investimeve në hartimin dhe zbatimin e projekteve per rehabilitimin e kanaleve ujitese me qëllim rritjen e aftësisë ujitese, rritjen e rendimenteve të kulturave dhe uljen e kostos së prodhimit. Nga veprat me te rendesishme te ujitjes eshte e domosdoshme te financohet rehabilitimi I kanalit ujites Tunel-Katjel-Rashtan i cili eshte ndertuar ne vitin 1978 dhe ka nje amortizim te plote.Ky kanal sherben edhe si ushqyes per rezervuarin Rashtan me kapacitet 600.000 m3 qe mban me ujitje fshatin Katjel dhe nje pjese te fshatit Prrenjas.

- Krijimi i kushteve për grumbullimin e ruajtjen e prodhimeve nëpërmjet ndërtimit të qëndrave frigoriferike (të paktën një qëndër grumbullimi në Prrenjas)
- Ngritja e nje pike grumbullimi dhe perpunimi per qumeshtin dhe mishin ne afersi te qytetit Prrenjas per t'ju pergjigjur ne kohe e me cilesi fermereve dhe banoreve te qytetit Prrenjas.
- Ne Njesine Administrative Qukes , krijimi i kushteve per kultivimin gjeresisht te rrushit (Vreshta) si zone prioritare nepermjet nxitjes se dokumentimit te siperfaqeve me qellim paisjen e fermereve me çertifikata pronesie si kusht themelor per thithjen e investimeve.
- Krijimi i nje fondi subvencionesh per fermeret me qellim ndihmen e drejtperdrejte te fermereve
- Monitorimi i perbashket i subvencioneve te dhena nga AZHBR etje. me qellim minimizimin e abuzimeve nga fermere te pandergjegjshem.

II.7 Tregtimi i prodhimeve pyjore drusore dhe jodrusore

Tregtimi i prodhimeve drusore dhe jodrusore për zonën në të cilat shtrihen pyjet dhe kullotat e EP Prrenjas, janë pothuajse inekzistente. Emigrimi i të rinjve dhe fuqisë aktive për punë, ka bërë që ekspansioni i pyllit të jetë i shpejtë duke ulur ndjeshëm sipërfaqet kullosore dhe në disa raste edhe tokat bujqësore.

Prodhimet drusore kryesisht përfaqësohen nga drutë e zjarrit dhe më rrallë nga prodhimet e tjera që lidhen me punimet pyjore (nga krasitjet apo rrallimet) të kryera nga fshatarët për nevojat e tyre. Përveç druve të zjarrit, çka përbën deri 85% të nevojave lokale, nga fshatarët mund të përdoren prodhime të tjera drusore, si material ndërtimi për ruajtjen e bazës ushqimore për bagëtitë dhe hunj gardhesh në tokat bujqesore. **Rezulton që tregtimi i prodhimeve drusore është i rrallë tek banorët**. Vlerësohet që tregtimi lidhur me shfrytëzimin e lëndës drusore për qëllim industriale mungon.

Prodhimet jodrusore gjithashtu përdoren më së shumti për nevojat lokale, me nivel të ulët tregtimi.Ne zone ka mjaft specie pyjore dhe bime mjeksore qe mund te grumbullohen dhe tregtohen pasi ka kerkesa ne treg per to, por per shkak te mungeses se fuqise punetore ato nuk vilen dhe nuk perdoren si burim te ardhurash nga banoret.

II.8 Gjuetia dhe peshkimi

Megjithë gjuetinë ilegale e cila eksiston në zonë, ka një shtim të ndjeshëm të kafshëve të egra dhe veçanërish të thëllëzës së malit, lepurit, pëllumbit të egër, derrit të egë, dhelprës, ujkut dhe kaprollit.
Në të gjithë sipërfaqen pyjore (por jo vetëm) prej 6170 ha, ka një mbipopullim me kafshë të egra sidomos me lepurin, thellëzën e malit, derrin dhe kaprollin. Ariu gjendet gjithashtu në këtë zonë por edhe ujku është parë në raste më të rralla.
Për shkak të moratoriumit aktual të gjuetisë së faunës së egër, gjuetia eshte nje aktivitet i munguar dhe nuk gjeneron të ardhura. Kafshët karakteristike të kompleksit të faunës janë ujku, dhelpra, derri i eger, lepuri, bufi i malit, qukapiku, bilbili, harabeli. Vertebroret janë perfaqesuar nga të gjitha grupet, si amfibet, zvarraniket, zogjtë dhe gjitarët. Për më tepër gjitarët perfaqesohen edhe nga lakuriqi hundepatkua i Mesdheut (*Rhinolophus euryale*), Lakuriqi hundepatkua i Blasit (*Rhinolophus blasii)* dhe lakuriqi i nates, veshmiu gishtëgjatë (*Myotis cappaccinii*), ketri (*Sciurus vulgaris*), gjumashi i majmë i pyllit (*Glis Glis*), gjumashi i lajthive (*Muscardinusavellanarius*). Në lidhje me jovertebroret, specie e rrezikuar është flutura (Euphydryas aurinia).
Me shumllojshmerine e habitateve te kesaj ekonomie takohen mjaft shpende si: Bufi - *Bubo bubo,* Huta bishtbardhë - *Buteo rufinus,* Gjeraqina këmbëshkurtër - *Accipiter brevipes,* Skifteri i Mesdheut - *Falco biarmicus,* Gjeraqina e shkurtës - *Accipiter nisus,* Gjeraqina - *Accipiter gentilis,* Qukapiku i përhimë - *Picus canus,* Kukuvajka mjekëroshe - *Tyto alba* dhe Skifteri kthetrazi - *Falco tinnunculus*, janë të pranishëm dhe indikatorë të gjëndjes së ekosistemeve të zonës. Reptilet përfaqësohen nga gjarprinjte, breshka e zakonshme (*Testudo hermanni*),dhe zhapiku i Gjelbër Evropian (*Lacerta viridis*).

II.9 Infrastruktura rekreative dhe didaktike

Ekzistenca e qytetit të Prrenjasit dhe zonave kryesore urbane në brendësi të ekonomisë, bën që edhe ekonomia pyjore më të njëjtin emër, të ketë infrastrukturë me vlera rekrative kryesisht, ndërsa për ato didaktike nuk ka ndonjë të dhënë, aktualisht.

Në këtë aspekt, qyteti i Prrenjasit si në periferi por edhe në brendësi të tij përbën një aspekt i cili dominon infrastrukturën rekreative. Në përgjithësi, kjo insfrastrukturë karakterizohet nga kulinaria ushqimore dhe ka karakter ditor, pa shtretër dhe struktura akomoduese.

Kulinaria ushqimore është mjaft e theksuar e ndihmuar kjo edhe nga fakti që në territor të Ekonomisë Pyjore, mbarështohen një numër i konsiderueshëm bagëtish si të imta apo edhe të trasha, por edhe nga prodhimet bujqësore të larmishme.

Qyteti i Prrenjasit ka qenë qytet i minatorëve dhe jeta e infrastruktura e tij janë të lidhura ngushtësisht me këtë aktivitet. Mjaft interesante në këtë aspekt vërehen ndërtimet karakteristike të ish uzinës së përpunimit të hekur nikelit, e vendosur në hyrje të këtij qyteti. Pas mbylljes së këtij aktiviteti, ndërtesa u braktis dhe simboli i këtij qyteti dukej si i fjetur. Në vitin 2008, kjo ndërtesë u shndërrua në një objekt të trashëgimisë kulturore, duke u shndërruar në një "panoramë" pikture të mbushur me nuse pashke, gjë që tërhoqi jo vetëm vemëndjen dhe kërshërinë e turistëve të huaj, por edhe ato vendas. Kjo ndërtesë vazhdon të jetë simboli i trashëgimisë kulturore të këtij qyteti si dhe të vetë kësaj ekonomie pyjore.

II.10 Prania e siteve dhe specieve me vlera të larta mbrojtjeje

Ne të gjithë zonën e marrë në studim nuk ka vende të veçanta dhe specie me vlera të larta për mbrojtje.

III. Situata aktuale e pyjeve dhe kullotave

III.1 Mbarështrimi dhe funksionet e pyjeve dhe kullotave

III.1.1 Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)

Tipet e përdorimit të territorit janë të pasqyruara mjaft qartë në tabelën nr 4. Siperfaqja totale është 7952.9 ha dhe propozohet po ajo sipërfaqe prej 7952.9 ha. Nga kjo sipërfaqe pyjore është evidentuar 6147.6 ha dhe propozohet që kjo sipërfaqe të arrijë në 6300 ha, me një shtesë prej 152.4 ha, e cila i dedikohet propozimeve dhe objektivave të këtij plani mbarështimi, për të pyllëzuar sipërfaqet të cilat mendohen të përshtashme për këtë qëllim.

Kullotat dhe livadhet në EP Prrenjas zëzë 986.7 ha dhe po kaq propozohen në objektivat 10 vjeçre të këtij plani. Kullotat kanë një shtrirje uniforme përgjatë gjithë sipërfaqes së EP dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre i përkasin çeltirave dhe sipërfaqeve që rrethohen nga sipërfaqet pyjore në vazhdim. Megjithatë në EP diferencohen edhe 3-4 parcela të veçanta me këtë përdorim dhe me një sipërfaqe të konsiderueshme që varion nga 20-150 ha.

Sipërfaqja me bimësi pyjore, referuar edhe në përkufizimin ligjor për këtë qëllim, e gjetur gjatë këtij plani mbarështimi në EP Prrenjas, është 477.6 ha dhe është propozuar që në 10 vitet në vijim ajo të zbresë në 346.3 ha. Diferenca prej 131.3 ha, i dedikohet masave silvikulturale të pyllëzimit të propozuara për t'u zbatuar gjatë 10 viteve në vijim.


PERDORIMI I TERITORIT

Perd.teritorit	Aktuale Siperfaqja ha	E propozuar Siperfaqja ha

Ekonomia : EP Prrenjas

Bashkiake		
Pyll	6147.6	6300.0
Sip.me bim. pyjore	477.6	346.3
Bujqesi	0.0	0.0
Kullote, Livadh	986.7	986.7
Urbane	0.0	0.0
Ujore	0.0	0.0
Kenete, Mocal	0.0	0.0
Djerr	36.9	18.7
Joproduktive	304.1	301.2
Total:	**7952.9**	**7952.9**

Total		
Pyll	6147.6	6300.0
Sip.me bim. pyjore	477.6	346.3
Bujqesi	0.0	0.0
Kullote, Livadh	986.7	986.7
Urbane	0.0	0.0
Ujore	0.0	0.0
Kenete, Mocal	0.0	0.0
Djerr	36.9	18.7
Joproduktive	304.1	301.2
Total:	**7952.9**	**7952.9**






Tabela III.1 Tabela me të dhëna mbi përdorimin e territorit në EP Prrenjas.

Sipërfaqet djerr, janë sipërfaqe të cilat nuk kanë bimësi karakteristike pyjore në momentin e inventarizimit të grumbullit dhe kjo për shkaqe që lidhen me humbjen e biomasës për shkaqe të aksidenteve natyrore dhe/ose humane, të tilla si zjarret, rrëshqitjet dhe katastrofat e tjera

natyrore.

Gjatë inventarizmit, një sipërfaqe prej 36.9 ha është evitentuar me formën e përdorimit "Djerr", në EP Prrenjas. Në objektivat 10 vjeçare të këtij pani mbarështimi, kjo sipërfaqe mendohet të reduktohet në 18.7 ha, në sajë të propozimit për t'u pyllëzuar. Sipërfaqet joproduktive (shkëmbore, zallishtet në shtretërit e përrenjve/lumenjve, dhe sipërfaqe të tjera pa prespektivë rimëkëmbje), janë evidentuar 304.1 ha dhe është propozuar që një sipërfaqe prej 2.9 ha e cila i përket një sipërfaqeje shtrat i lumit përrenjas, që të pyllëzohet me bimësi tipike të shtretërve të lumenjve si plep, shelg e akacie.

Theksojmë se zonat urbane (zonat e banimit, trojet, fshatra dhe qytete), tokat bujqësore dhe ato ujore (liqene dhe basene ujore), janë përjashtuar nga konturi i EP Prrenjas, me synimin për të mos krijuar mbivendosje artificiale kadastrale, pasi ato administrohen dhe shënohen si elementë kadastralë të institucioneve të tjera.

III.1.2 Regjimi i qeverisjes (aktuale dhe propozimet)

Forma e qeverisjes së ekonomisë merr për bazë mbarështrimin e mëparshëm dhe në të shumtën e rasteve e ruan atë me përjashtime të rralla kur siperfaqja ka ndërruar funksion.

Më poshtë po japim të detajuar me tabelë, gjendjen aktuale dhe të propozuar të formës së qeverisjes në ekonommine pyjore "Prrenjas".

FORMA E QEVERISJES

Forma e qeverisjes	Aktuale Siperfaqja ha	%	E propozuar Siperfaqja ha	%
Ekonomia : EP Prrenjas				
Trungishte	174.9	2.8	174.9	2.8
Cungishte	4724.9	76.6	4724.9	76.6
Trung. e parregullt	0.0	0.0	0.0	0.0
Cung. e perbere	73.6	1.2	73.6	1.2
Shkurre	1196.3	19.4	1196.3	19.4
Livadh	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote me drure	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote me shkurre	0.0	0.0	0.0	0.0
Total:	**6169.7**		**6169.7**	

Ne Total:




Tabela nr.III.1.2 Forma e qeverisjes sipas mbarështrimit aktual dhe atij të propozuar.

Sic shihet edhe nga pasqyra, nuk ka ndryshime thelbësore të formës së qeverisjes nga ç'farë është evidentuar në këtë plan mbarështimi dhe me atë ç'farë është propozuar në objektivat e 10-vjeçarit të këtij plani.

Sikurse mund të shikohet forma e qeverimit e evidentuar nga inventarizimi i grumbujve të kësaj ekonomie, është 174.9 ha dhe po aq propozohet të mbetet në vijim.

Ndërsa në formën e qeverimit cungishte janë evidentuar 4724.9 ha dhe po kaq mbeten edhe në objektivat e 10 vjeçarit.

Në formën e qeverimit shkurre janë evidentuar 1196.3 ha me shkurre dhe po aq mbeten në vijim.

Ashtu sikurse mund të shikohet, forma e qeverimit "Cungishte" zotëron formën e qeverimit të kësaj ekonomie me 4724.9 ha ose 76.6% të totalit të ekonomisë, krahasuar me 1196.3 ha ose 19.4% në formën e qeverimit "Shkurre" e cila renditet ne vendin e dytë dhe në vendin e tretë renditen trungishtet më 174.9 ha ose 2.8% të toalit të EP.

III.1.3 Ndarja e Ekonomisë Pyjore në parcela dhe n/parcela

Ekonomia pyjore Prrenjas, është njësi homogjene territoriale. Si e tillë, bazuar në konfiguracionin e terrenit, në homogjenitetin e grumbujve si dhe karakteristikat dendrometrike e morfologjike të grumbujve pyjorë, ajo për bëhët 165 parcela dhe 481 njësi administrative (nën-parcela) organizimi brenda saj.

Ndarja e ekonomisë në ngastra dhe n/ngastra bëhet me qëllim sigurimin e orientimit, organizimit, udhëhëqjen dhe kontrollin e kryerjes së punimeve pyjore (pyllëzime, përmirësime, shfrytëzime, ripërtëritjen e pyllit, etj) si dhe trajtimi i përshtatshëm që duhet zbatuar në pyll. Në ndarjen për ngastër mbahen parasysh format natyrore të rilievit (si përrenjë, lugina, kulme etj).

Në përgjithësi ne kemi ruajtur kufijtë e vjetër të ndarjes së ngastrave duke plotësuar dhe një kusht të manualit të punimeve të terrenit. N/ngastra duke qënë njësia bazë për studimin e pyllit dhe planifikimin e punimeve ka për bazë homogjenitetin e pyllit. Sipërfaqja minimale është 0.5 ha, por për të shmangur mosfunksionimet e programeve kompjuterike dhe mbivendosjet në harta ka dhe njësi me sipërfaqe më të vogël.

Në mjaft raste ka patur ndarje të reja në varësi të gjëndjes aktuale të pyllit. Madhësitë e ngastrave dhe n/ngastrave plotesojnë tërësisht kërkesat e Manualit të Mbarështrimit, për këtë qëllim në pyjet prodhues ashtu dhe mbrojtës emërtimi i çdo n/ngastre është i ndryshëm brenda një ngastre.

Teksojmë gjithashtu, se për shkak të shpalljes së sipërfaqes si zonë e mbrojtur, ka një shkëputje të numrave rendorë por kjo nuk përbën ndonjë problem sa kohë që identiteti i ngastrës

është ruajtur, duke marrë në konsideratë edhe historikun e saj, e cila është një rubrikë e posaçme në fletën e përshkrimit parcelar.

IV. Përshkrimi i stacionit

IV.1 Klima

Ekonomisë Pyjore "Prrenjas" bën pjesë në zonën e klimës mesdhetare paramalore. Studimi i klimës në këtë ekonomi është bërë duke u bazuar në të dhënat metereologjike të rregjistruara në vite nga stacioni me afer ekonomise, atë të qytetit të Prrenjasit. Klima e kësaj ekonomie varet nga barriera malore që formohet nga kurura e Malit të Qafës së Thanës në të gjithë gjatësinë Lindore të ekonomisë, i cili përbën edhe kufirin natyror me Pogradecin. Ky formacion pengon disi erërat lindore dhe ato jugore të depërtojnë në brendësi të ekonomisë. Si pasojë ekonomia karakterizohet nga verë të nxehta kryesisht për shkak edhe të kundrejtimit dominues perëndimor dhe jug perëndimor dhe dimra të ashpër për shkak të klimës kontinentale.

Bashkia e Prrenjasit, sipas ndarjes klimatike te Shqiperise, ndodhet ne zonen klimatike mesdhetare paramalore, ne nenzonen klimatike mesdhetare paramalore jugore.

Larmia e formave te relievit te kesaj nenzone ndikon ne regjimin e elementeve klimatik. Pozicioni qe ka kjo bashki, larg bregdetit dhe ne lartesi mbi nivelin e detit, ben qe temperatura e ajrit te karakterizohet nga vlera relativisht te ulta. Kjo eshte me e theksuar gjate stines se dimrit ku ererat qe fryjne nga brendesia e territorit ndikojne dukshem ne uljen e temperatures.

Temperatura mesatare e ajrit varion nga 2.72C ne Janar deri ne 21.02C ne Korrik. Temperatura mesatare maksimale luhatet nga 6.82C ne Janar deri ne 28.2°C ne Korrik e Gusht. Temperatura mesatare minimale luhatet nga -1.42C (Janar) deri ne 13.82 (Korrik). Nje parameter tjeter i rendesishem qe shpreh regjimin e temperatures se ajrit eshte vlera ekstreme qe ka arritur temperatura ne kete zone.

Konkretisht, temperatura maksimale e regjistruar eshte 40.7°C me 14 shtator 1957 dhe temperatura minimale eshte regjistruar -15.7°C regjistruar ne vitin 1968.

Reshjet. Regjimi i reshjeve ne zonen e Prrenjasit eshte nje regjim mesdhetar. Ky regjim karakterizohet nga sasi te bollshme gjate gjysmes se ftohte te vitit dhe reshje te pakta gjate stines se veres. Shuma vjetore e reshjeve eshte rreth 870 mm, 63% e se ciles bie gjate stines se vjeshtes dhe dimrit dhe 37% ne dy stinet e tjera. Muaji ne te cilin bien me shume reshje eshte muaji Nentor gjate te cilit bien mesatarisht 119.0 mm, ndersa muaji me ithate eshte muaji Korrik ne te cilin bien vetem 26.6 mm shi. Temperatura mesatare vjetore eshte 13.4°C. Nje parameter tjeter i rendesishem qe shpreh regjimin e temperatures se ajrit eshte vlera ekstreme qe ka arritur temperatura ne kete zone. Numri i diteve me reshje eshte nje parameter tjeter i rendesishem i cili shpreh regjimin e reshjeve. Numri i diteve me reshje me shume se 1 mm qe vrojtohen gjate

nje viti eshte mesatarisht 92.1 dite. Shperndarja gjate vitit e numrit te diteve me reshje eshte praktikisht e njejte me ate te sasise se reshjeve. Muaji me numrin me te madh te diteve me reshje eshte muaji dhjetor (10.7 dite) ndersa muaji me numer mete vogel te diteve me reshje eshte muajl Korrik {3.9 dite). Nje indikator me perdorim te gjere ne ndertim, hidroteknike, agrokulture, etj. eshte edhe intensiteti mete cilin bien reshjet. Ne kete kuader treguesi kryesor dhe me i perdorshem eshte maksimumi 24 ore i reshjeve si dhe vlerat e pritura per periudha perseritje te ndryshme. VIera me e larte e reshjeve te vrojtuara, te rena brenda 24 oreve, eshte 102.3 mm/24ore, eshte regjistruar ne nentor 1962. Kryesisht vlerat me te medha te maksimumeve 24 oreshe te reshjeve vrojtohen gjate periudhes se ftohte te vitit, por nuk perjashtohen rastet kur edhe ne stinen e ngrohte te vitit te vrojtohen vlera te larta te reshjeve qe bien brenda 24 oreve.

Konkretisht mund te permendim sasine prej 90.5 mm te rene ne qershor 1981. Ne qytetin e Prrenjasit, mesatarisht ne nje vit vrojtohen 12.1 dite me shtrese debore. Lartesia me e madhe e shtreses se debores e vrojtuar eshte 57 cm.

Burimi: Plani i Pergjithshem Vendor, Bashkia Prrenjas (2016-2030).

Periudha e vegjetacionit fillon në fund të javës së parë të Prillit dhe mbaron në fund të javës së parë të Nëntorit për lartësinë deri në 900 m. Ndërsa për lartësinë deri në 1400 m, fillimi i vegjetacionit konstatohet në javën e parë të Majit, dhe mbaron në fillim të Tetorit.

Megjithatë, vitet e fundit është vënë re nje shmangie e këtyre mesatareve vjetore për shkak të ndryshimeve klimaterike.


Rrjeti hidrografik është i varfër me përrenj sezonalë kryesisht dimërorë që nuk kanë fuqi errodive të madhe gjatë fryrjeve dimërore, për shkak të formacioneve magmatikë dhe gëlqerore, në të cilët ato janë vendosur.

<u>Erërat</u> Në përgjithësi erërat fryjnë nga drejtime të ndryshme në këtë ekonomi, por mbizotërojnë erërat që fryjnë nga drejtimet Jug-Lindje, Lindje, Jugore dhe Veriore, të cilat fryjnë gjatë gjithë vitit.

Erërat në drejtim Veri-Përëndim në përgjithësi fryjnë në përiudhën e verës, që shpesh kane dhe shpejtësi të madhe.

Si përfundim mund të themi që klima është një faktor pozitiv duke krijuar kushte të përshtatshme për zhvillimin e pyjeve dhe të bimësisë në përgjithësi, por duhet theksuar se erërat e forta dhe reshjet e shumta të dëborës në këtë ekonomi bëjnë që të takohen drurë të rrëzuar nga erërat dhe jo rrallë edhe nga orteqet, të cilat thuajse janë periodikë në pjesën e sipërme të vegjetacionit pyjor. Në pjesën ë sipërme të ekonomisë dhe zakonisht jashte arealit te tyre takohen drurë të shtrembër qe vijne si pasoje e reshjeve te bores apo drejtimit te perhershem te ererave.

Grafiku i rreshjeve dhe i temperaturave



IV.2 Topografia dhe morfologjia

Ekonomisë Pyjore "Prrenjas" shtrihet ndërmjet brezit të lartësive 361.3 m ajo minimale dhe 1452.9 m (lartësia maksimale), mbi nivelin e detit. Lartësia maksimale e ekonomisë prej 1452.9 m, arrihet në parcelen 154/a dhe ajo minimale prej 361.3 m në parcelën 24/c të kësaj ekonomie.

Sipas tabelës së përllogaritjeve të dala nga punimet e zyrës (Tab. Nr. 6), grumbujt e ekonomisë pyjore Prrenjas, kanë këtë shpërndarje sipas lartësisë mbi nivelin e detit:

- Në lartësinë 401-600 m shtrihen 632 ha ose 10.2% e grumbujve të kësaj ekonomie
- Në lartësinë 601-800 m shtrihen 1462.6 ha ose 23.7% e totalit të grumbujve të ekonomisë
- Në lartësinë 801-1000 m shtrihen 2032.71 ha me pyje ose 32.9% te totalit të grumbujve të ekonomisë.
- Në lartësinë 1001-1200 m janë të vendosura 1373 ha me pyje ose 22.3% të totalit të grumbujve
- Ndërsa në lartësinë 1201-1400 m mbi nivelin e detij janë vendosur vetem 669 ha ose 10.8% e pyjeve

Dominanca e grumbujve të ekonomisë vërehet në lartësinë 801-100 m mbi nivel deti me një përfaqsim të grumbujve prej 2032 ha ose 33% të totalit të sipërfaqes së EP Prrenjas.

Siperfaqja sipas lartesise mbi nivelin e detit dhe funksioneve kryesore

(perqindjet ne lidhje me totalin e siperfaqes sipas funksionit kryesor)

Ekonomia Pyjore : EP Prrenjas

Funksioni	0-200m		201-400m		401-600		601-800m		801-1000m		1001-1200m		1201-1400m		1401-1600m		1601-1800m		1801-2000m		>2000m		Total	
	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%	ha	%
Prodhues	0	0.0	0	0.0	632.048	10.2	1462.62	23.7	2032.71	32.9	1373.2	22.3	669.13	10.8	0	0.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0	6169.7	

Tabela VI.2 Shtrirja e grumbujve sipas klasave të lartësisë së terrenit në EP Prrenjas

Sa më sipër konkludojmë se lartësia mesatare e ekonomisë pyjore Prrenjas është 900 m mbi nivelin e detit.


Sa i takon kundrejtimit të përgjithshëm të ekonomisë, dominon kundrejtimi Jugor, ndërsa për shkak të morfologjisë dhe thyerjeve të terrenit, të gjitha format e kundrejtimit gjenden në EP Prrenjas.

Siperfaqja sipas funksioneve kryesore dhe kundrejtimeve


Kundrejtimi	Siperfaqja (ha)	% ndaj totalit te funksionit	% ndaj totalit te siperfaqes pyjore
Ekonomia : EP Prrenjas			
Prodhues			
Veri-Lindj	222.03	3.6	3.6
Lindje	742.636	12.0	12.0
Jug-Lindje	798.24	12.9	12.9
Jug	1638.659	26.6	26.6
Jug-Peren	1092.837	17.7	17.7
Perendim	1084.288	17.6	17.6
Veri-Peren	590.963	9.6	9.6
Totali i funksionit :	6169.653	100.0	100.0
TOTALI I EKONOMISE	**6169.653**		**100.0**

Tabela VI.3 Shtrirja e grumbujve sipas kundrejtimit të terrenit në EP Prrenjas

Ashtu sikundër vërehet edhe nga tabela, kundrejtimi Jugor zotëron në 163836 ha ose 26.6% të totalit të përgjithshëm të ekonomisë, i ndjekur nga ai Jug-Perëndimor me 1092.8 Ha ose 17.7% të sipërfaqes e kështu me radhë. Të dhëna të detajuara jepen në tablelën nr. VI. 3, më sipër. sipër. Më poshtë po paraqesim edhe nje hartë të kundrejtimeve krtyesore te EP Prrenjas.


HARTA E "KUNDREJTIMEVE" EKONOMIA PYJORE PRRENJAS
1 centimeter = 250 meters
N
W
E
S
Legend
Vendbanime
Kufi Bashkie
Kufiri Ekonomisë
Kufi Parcele
Flat (-1)
North (0-22.5)
Northeast (22.5-67.5)
East (67.5-112.5)
Southeast (112.5-157.5)
South (157.5-202.5)
Southwest (202.5-247.5)
West (247.5-292.5)
Northwest (292.5-337.5)
North (337.5-360)
0 1,250 2,500
Meters
Coordinate System: WGS 1984 UTM Zone 34N
Projection: Transverse Mercator
Datum: WGS 1984
False Easting: 500,000.0000
False Northing: 0.0000
Central Meridian: 21.0000
Scale Factor: 0.9996
Latitude Of Origin: 0.0000
Units: Meter

Sa i takon pjerrësisë, grumbujt e EP Prrenjas dominojnë në pjerrësinë 11-40%, në masën 69.8% ose 4306 ha, dhe funksioni i tyre eshtë i gjithi prodhues. Sikurse vërehet edhe nga harta më poshtë:



Siperfaqja sipas pjerresise dhe funksioneve kryesore

Funksioni	Siperfaqja (ha)	% ndaj totalit te pjerresise	% ndaj totalit te siperfaqes pyjore
Ekonomia : EP Prrenias			
0 - 10%			
Prodhues	158.14	100.0	2.6
Total :	158.14		2.6
11 - 40%			
Prodhues	4305.957	100.0	69.8
Total :	4305.957		69.8
41 - 70%			
Prodhues	1516.326	100.0	24.6
Total :	1516.326		24.6
71 -100%			
Prodhues	189.23	100.0	3.1
Total :	189.23		3.1
TOTALI I EKONOMISE :	**6169.653**		

Tabela VI.4 Shtrirja e grumbujve sipas klasave të pjerrësisë së terrenit në EP Prrenjas


Nga sa më sipër konkludohet se: Grumbujt e EP Prrenjas vendosen në një territor me topografi pjesërisht të thyer, me lartësi mesatare mbi nivelin e detit 900 m. Shformimet e terrenit janë të vazhdueshme duke e konsideruar këtë ekonomi me morfologji kryesisht të thyer. Këta forma, sigurisht që ndikojnë në përhapjen e brezave të bimësisë dhe vendosjes së tyre të përgjithshme ne nivel ekonomie.

IV.3 Gjeologjia

Grumbujt pyjorë të ekonomisë Prrenjas, shtrihen 34.7% mbi formacione gëlqerore dhe e gjithë pjesa tjetër prej 65.3% në formacione ultrabazike (magmatike). Ka një përqindje të vogël, por jo të konsiderueshme, të tokave aluvionale të cilat dominojnë tokat afër shtretërve të lumenjve (trupave ujorë).


Formimi i formacioneve gjeologjike të EP Prrenjas, i përket Triasikut të sipërm dhe Jovasikut të poshtëm. Përfaqësimi i gëlqerorëve përbëhet nga nënllojet gëlqerorë me megalodantë, gëlqerorë stromatolitikë, dolomite dhe gëlqerorë radioloritikë me silicorë. Ndërsa shkëmbenjtë ultrabazikë, karakterizohet nga magmatikët, të cilët janë karakteristike edhe për pasuritë nëntokësore të bashkisë Prrenjas të kryesuara nga mineralet e kromit dhe ato të hekur nikelit.

Në vatra të vogla takohet edhe sistemi Kretarc, i përfaqësuar nga Kretaku i sipërm i pandove gëlqerorë me rendiste gëlqerore të dolomitizuar e gëlqerorë pllakorë. Këta formacione karakterizohen nga prania e shumë gurëve në sipërfaqe dhe në përgjithësi me toka skleretike dhe të thata. Më poshtë e ilustruar edhe me hartë.



IV.4 Tokat

Tokat e ekonomisë pyjore të marrë në studim shtrihen përgjithësisht në lartësine 550-1450 m mbi nivelin e detit që bëjnë pjesë në brezin e dytë të zonalitetit vërtikal të tokave. Tokat e kësaj ekonomie si të gjitha tipet e tokave janë formuar dhe zhvilluar nën ndikimin e klimës, rilievit, të formacioneve shkëmbore dhe nën ndikimin e bimësisë ekzistuese. Harta ilustruese më poshtë:



Në ekonoine pyjore "Prrenjas", në bazë të klasifikimit F.A.O-UNESKO dallohen qartë tre tipe tokash, të cilat jepen të detajuara në tabelën nr. 11 në vijim.Tokat e hinjta kafe (Gray cinnamon) zënë pjesën kryesore të zonës së studimit. Ato zënë pjesën më të madhe të sipërfaqes dhe jane te vendosur mbi shkembinj seprentinor, flishor dhe nje pjese mbi shkembinj karbonatik. Nga nentipet kryesore te ketyre tokave ndeshen:

(i) kafe; (ii) hinjta kafe dhe (iii) murrme pyjore. Përgjithësisht ato përfaqësojnë një profil të diferencuar, pasi ngjyra e horizontit të sipërm A është e zbehtë dhe horizonti B dhe C janë në ngjyrë gri në të verdhë. Përbërja mekanike (tekstura) është subargjilore e mesme. Sipas inventarizimit në sipërfaqet provë, trashësia e lëgushës dhe humusit kryesisht është më pak se 3 cm, dhe atje ku kalohet kjo trashësi, shkon nga 3 deri 5 cm. ***Ashtu sikurse mund të vërehet edhe nga tabela më poshtë, tipi i tokave të hinjta kafe zotëron llojet e tokave në EP.***


IV.5 Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë

Zona e Prrenjasit paraqet larmishmëri formash, gjendjesh dhe dinamike. Burimet hidrike të zonës janë mjaft të pasura dhe të larmishme në formë. Burimi kryesor është rrjedhja e sipërme e shtratit të lumit Shkumbin, që formon dhe grabenën më tipike të zonës. Së dyti, ka mjaft burime ujore malore që dergjen në të dyja shpatet kufizuese të lumit Shkumbin. Dhe së treti janë burimet ujore statike, pra liqenore ku padyshim më të rëndësishme janë ato të liqeve të Rrajcës, rezervuarë të cilat krijojnë impakt pozitiv mjedisor. Ujrat karakterizohen nga parametra fiziko- kimik dhe organoleptik të përshtashëm për pirje por dhe për shfrytëzim në ekonomitë e njësive. Hulumtimet konstatojnë se sipërfaqet ujore liqenore natyrale dhe artificiale kanë një trend në rritje të shkallës së ndotjes së tyre.

Zona natyrore e mbrojtur, ndodhet në basenin ujëmbledhës të lumit të Bushtrices, i cili në këtë zonë ka prurje të mëdha, gjatësia totale brenda zonës është 18,5 km dhe 7km jashtë saj e derisa derdhet në Shkumbin.

Liqenet Në këtë zonë ndodhen 4 liqene në shpatin lindor të malit të Shebenikut. Janë liqenet e vendosur në fundin e një kompleksi akullnajor, ata janë të ndarë njeri nga tjetri me depozitime moremike dhe shkëmbinj njërrësore. Thellësia e liqeneve shkon disa metra, ato kanë ujë të ftohtë dhe shumë të pastër. Gjatë dimrit liqenet ngrijnë në sipërfaqe shtrese të fortë akulli, mbi të cilën bie dëbora deri kur fillon shkrirja e akullit në pranvere. Këto liqene kanë bukuri të rralla natyrore.Tre liqene që njihen me emrin liqene të Rrajcës kanë siperfaqen më të madhe, ato ndodhen në shpatin lindor të Shebenikut, poshtë majes së Fursit.

Si rezultat zona e marrë në studim, karakterizohet nnga një rrjet hidrologjik i varfër me rrjet i cili në më shumë se gjysmën e vitit nuk është eksistent. Më poshtë, rtjeti hidrik është ilustruar edhe me hartë:



IV.6 Erozioni në sipërfaqet e pjerrëta dhe rrjedhat ujore

Në përgjithësi EP Prrenjas karakterizohet nga formacione gjeologjike të cilat parqesin qëndrueshmëri karshi fenomenit të erozionit. Më i theksuar ky fenomen paraqitet anës përrenjve, ku si rezultat i prurjeve në stinën e reshjeve, erozioni në shpate është i dukshëm i shoqëruar ndonjëherë edhe me rrëshqitje.

Në objektivat e këtij plani mbarështimi kemi planifikuar ndërtim të pritave malore dhe të pritave me gardhe teke e çifte, të shoqëruara gjithmonë me pyllëzime, më synimin për të zgjidhur përfundimisht problematikat e erozionit atyku ato janë të shfaqura.

Sa u takon sipërfaqeve të tjera me pjerrësi të madhe në të gjithë zonën e studimit, theksojmë se nuk ka shenja të erozionit për shkak të veshjes me bimësi të konsiderueshme dhe formacioneve të tokës.

Edhe rrjedhat ujore në përgjithësi, paraqiten tërësisht të stabilizuara dhe aspak kërcënuese për të shkaktuar erozion apo problematika të tjera në zonat ku kalojnë.

IV.7 Rrëshqitjet e tokës

Veshja e sipërfaqes së zonës së studimit me pyje, ka eliminuar tërësisht fenomenin e rrëshqitjes, pavarësisht territoreve të thepisura.

Nuk është konstatuar asnjë zonë problematike me rrëshqitje në të gjithë EP Prrenjas.

V. Vegjetacioni dhe biodiversiteti

V.1 Brezat bio-klimatikë

Zona e studimit, për vetë pozicionin fiziko-gjeografik, karakterizohet nga ekzistenca e brezit të III bio-klimatikë:

III. **Brezi i Pyjeve dhe Shkurreve Termofile,**

Ky brez nis me **nën-brezin e drurëve halorë** i cili përfaqësohet nga Pisha e zezë (Pinus nigra), e gjitha e kultivuar. Ky lloj vegjeton dobët për shkak të vendosjes së saj mbi toka skeletike, kryesisht magmatike. Kultivimi i saj jashtë arealit natyror, bën që ajo të jetë nën presionin e kushteve klimatikë të cilët favorizojnë dëmtuesin e saj, të njohur si procesionaria e pishës. Të gjitha masivet e pishës së zezë në EP Prrenjas, janë të prekur pa përjashtim nga ky dëmtues, i cili ka shkaktuar

dëmtime të shumta të kërcellit, ulje të rritjes natyrore, deformime në trung e kurorë dhe kërcënim deri në tharje të disa indivitëve me probleme të tjera. Ky brez ka një moshë mestare prej 45 vitesh i cili përkon me plantacionet e mbjella rreth viteve 1980. Ka volum të llogaritshëm, por karakteristikat dendrometrike shfaqin shangie të theksuar nga normaliteti natyral i pishës së zezë.

Nën-brezi i Dytë i Bresit të Pyjeve dhe Shkurreve Termofile, përbëhet nga "Shkurret halore", të cilat identifikohen nga prania e llojit Dëllinjë e Kuqe (Juniperus oxycedrus L). Ky brez dominon thuajse mbi 90% të EP Prrenjas, dhe prania e dëllinjës, flet për degradimin e ekosistemit dhe grumbujve të kësaj ekonomie. Zakonisht dëllinja shfaqet si nënpyll, në rastet kur grumbulli është drejt fazës së stabilizimit natyral, duke bërë që llojet e tjera të dushqeve të dominojnë më prezencën e tyre si në sasi ashtu dhe në zotërimin e lartësisë së grumbullit.

Nën-brezi i Tretë i Bresit të Pyjeve dhe Shkurreve Termofile, përbëhet nga "Drurët fletorë". Ky nënbrez karakterizohet nga prania e llojeve qarr (Querqus cerris L), Bulger (Querqus trojana Ëebb), shparth (Querqus frainetto Ten), dhe pjesëmarrja e llojeve të tjerë si krekez dhe panjë. Këta lloje formojnë grumbuj në formë të thjeshtë ose të përzier, ku këta të fundit përbehen nga përzierja e qarrit dhe shparthit kryesisht, ndërsa bulgeri takohet në formate të thjeshta dhe kryesisht pa përzierje. Në përgjithësi llojet e vërejtura gjatë inventarizimit në këtë brez, janë drejt një faze më përmirësim të dukshëm duke krijuar premisa për një grumbull të së ardhmes i cili jo vetëm synon të vegjetojë, por edhe të japë prodhim. Aktualisht paraqitet me volum të llogaritshëm, por në minimumin e tij jetik. Me objektivat 10 vjeçarë të këtij plani mbarështimi, synohet përmirësim i ndjeshëm i grumbujve që formohen nga llojet e drurëve në këtë brez klimatik.

Nën brezi i katërt përbëhët nga "Shkurret Fletorë" të këtij brezi. Llojet tipike që përfaqësojnë këtë nënbrez janë: bushi (Buxus sempervirens L), shkoza e zezë (Carpinus orientalis L), lajthia e egër, frshëri i bardhë, cermedelli, murrizat, trëndafili iegër, etj.

Tipike e EP Prrenjas është bushi, i cili për fat të keq gjatë viteve të fundit është dëmtuar rëndë deri në tharje të plotë nga insekti "Flutura e bushit". Në të gjithë territorin e EP, me përjashtime të rralla, shkurrja e bushit gjendet aktualisht e tharë plotësisht. Në shoqërimet e saj kryesisht me dëllinjën e kuqe, bushi konsiderohet thuajse i tharë plotësisht dhe eksistenca e bushit vazhdon të konsiderojë sipërfaqen ende si pyjore. Sa i takon pranisë së llojeve të tjera në këtë brez klimatik, dominon shkoza e zezë e cila formon kryesisht grumbuj të pastër, por edhe e përzier me të gjitha llojet e sipërcituara. Kryesisht është pa volum të llogaritshëm, për shkak të stadit degradues, por ajo që shikohet është se edhe ky brez po shkon drejt një përmirësimi të dukshëm dhe kjo falë qetësisë së krijuar nga abandonimi i zonave rurale dhe rënies së presionit të kullotjes.

Në përfundim konludojmë se: Ekonomia Pyjore Prrenjas, karakterizohet në 100% të sipërfaqes së saj prej 6170 ha, nga Brezi bio-klimatik i tipit: "Brezi i Pyjeve dhe Shkurreve Termofile".

V.2 Pyjet dhe kullotat

Nga inventarizimi i grumbujve pyjorë të EP Prrenjas dhe nga përpunimi i të dhënave në programin M.Access DB, ka rezultuar panorama e mëposhtme:

PERDORIMI I TERITORIT

Perd.teritorit	Aktuale Siperfaqja ha	E propozuar Siperfaqja ha

Ekonomia : EP Prrenjas

Bashkiake		
Pyll	6147.6	6300.0
Sip.me bim. pyjore	477.6	346.3
Bujqesi	0.0	0.0
Kullote, Livadh	986.7	986.7
Urbane	0.0	0.0
Ujore	0.0	0.0
Kenete, Mocal	0.0	0.0
Djerr	36.9	18.7
Joproduktive	304.1	301.2
Total:	**7952.9**	**7952.9**

Total		
Pyll	6147.6	6300.0
Sip.me bim. pyjore	477.6	346.3
Bujqesi	0.0	0.0
Kullote, Livadh	986.7	986.7
Urbane	0.0	0.0
Ujore	0.0	0.0
Kenete, Mocal	0.0	0.0
Djerr	36.9	18.7
Joproduktive	304.1	301.2
Total:	**7952.9**	**7952.9**

Ashtu sikurse mund të shikohet, EP Prrenjas ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 7953 ha, ku nga kjo:

- 6148 ha janë inventarizuar aktualisht me formë përdorimi "pyll"
- 987 ha janë inventarizuar dhe evidentuar me fomë përdorimi "kullotë"
- 447 ha me formë përdorimi "Sipërfaqe me bimësi pyjore"
- 304.1 ha me formë përdorimi "Joproduktive", dhe

- 37 ha, janë evidentuar nga invenyarizimi i kryer, me formë përdorimi "Djerr".

Për të gjitha format e përdorimit të evidentuara gjatë inventarizimit të kryer në EP Prrenjas, rezulton se pronësia është ajo bashkiake dhe konkretisht në pronësi të Bashkisë Prrenjas.

V.3 Tipet e pyjeve

Nga verifikimi i situatës në terren, nëpërmjet inventarizimit me sipërfaqe provë të përhershme janë evidentuar tipet e pyjeve si në tabelën në vijim:

Tipet e grumbullit aktual sipas funksioneve/ perqindja ndaj totalit te siperfaqes

Tipi i Grumbullit	Total		Funksioni							
			Prodhues		Mbrojtes		Rekreacion		Konservim	
	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %
Ekonomia pyjore EP Prrenjas										
Pyje me ah	31.27	0.5	31.27	0.5	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me pishe te zeze	91.816	1.5	91.816	1.5	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje pishe te zeze me dushqe	34.45	0.6	34.45	0.6	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me makie	29.21	0.5	29.21	0.5	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje azonale (pyje te luginave ose te bregut)	17.36	0.3	17.36	0.3	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me bulger	964.29	15.6	964.29	15.6	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje shkoze me dushqe	226.73	3.7	226.73	3.7	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me shkoze te zeze	652.16	10.6	652.16	10.6	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje qarri me shkoze	18.4	0.3	18.4	0.3	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me qarr	509.85	8.3	509.85	8.3	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje qarri me dushqe te tjere	1322.7	21.4	1322.7	21.4	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me shpardh	290.05	4.7	290.05	4.7	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje shpardhi me dushqe te tjere	299.55	4.9	299.55	4.9	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me bunge te perzier me ah	8.25	0.1	8.25	0.1	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me bunge	1673.6	27.1	1673.6	27.1	0	0.0	0	0.0	0	0.0
TOTALI I EKONOMISE:	**6169.653**	100.0	6169.7	100.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0

EP Prrenjas karakterizohet nga 15 tipe pyjesh kryesisht. Sipërfaqen më të madhe në të gjithë ekonominë e zë tipi i pyjeve:

- "Pyje me bungë" është tipi që zotëron mbi të gjitha tipet e tjera pyjore që shfaqen në EP Prrenjas. Ai zë një sipërfaqë prej 1673 ha ose në 27% të totalit të ekonomisë. Në përbërjen llojore dominon bunga me grumbuj të thjeshtë dhe të pastër vetëm me llojin bung, kryesisht. Ka prani kryesisht të dëllinjës së kuqe, qarrit dhe shkozës së zezë si lloje pjesëmarrës.
- "Pyje qarri me dushqe të tjerë", i cili shtrihet në një sipërfaqe prej 1323 ha ose në 21.4% të totalit të ekonomisë. Në përbërjen llojore të këtij tipi pyjor, kryeson qarri i cili shfaqet

i përzier me llojet bungë, bulger ose shparth. Shkoza dhe dëllinja e kuqe shfaqen zakonisht si kat i dytë në këtë tip pyjor.

- "Pyje me bulger", është i treti për nga madhësia e sipërfaqes që zë në EP Prrenjas. Ky tip pyjor shtrihet në 964.3 ha ose në 15.6% të totalit të sipërfaqes së ekonomisë dhe dominohet tërësisht nga bulgeri, i cili ka tendencën të formojë grumbuj të pastër kryesisht. Dëllinjë e kuqe shoqëron kudo këtë tip pyjor, por si nënkat.
- "Pyje me shkozë të zezë", është tipi i katërt për nga madhësia e sipërfaqes që zë. Ky tip shtrihet në 652 ha ose në 10.6% të totalit të sipërfaqes së EP Prrenjas. Gjendet kryesisht në formën e qeverimit shkurre dhe ka pjesëmarrje të dushqeve kryesisht qarr e bungë.
- "Pyje me qarr", renditen në vendin e pestë për nga madhësia e sipërfaqes që zënë në ekonomi. Ato shtrihen në 509.8 ha, ose në 8.3 % të totali të sipërfaqes. Janë pyje të thjeshtë të qarrit me pjesëmarrje të dëllinjës së kuqe, shkozës dhe me rrallë akoma bungë, bulger e shparth. Janë 100% në formën e qeverimit cungishte.
- "Pyje shparti me dushqe të tjerë" është tipi në radhë, i cili shfaqet në 299.5 ha, ose në 5% të sipërfaqes së përgjithshme të ekonomisë. Dominohet nga lloji shparth, por me përzierje të kombinuar kryesisht me qarrin, bulgerin shkozën osë bungën më rrallë. Është 100% në formën e qeverimit Cungishte.
- "Pyje me shparth", shfaqen në 290 ha ose në 4.7 % të totalit të sipërfaqes së ekonomisë. Janë pyje të thjeshtë të shparthit por me pjesëmarrje te llojeve qarr kryesisht e shkozë. Janë 100% në formën e qeverimit cungishte.
- "Pyje shkoze me dushqe", janë tipi i tetë në renditje dhe zënë një sipërfaqe prej 226.7 ha, ose 3.7 % të totalit të përgjithshëm të sipërfaqes. Janë kryesisht në formën e qeverimit cungishte në masën 60% dhe në 40% të rasteve shfaqen si shkurre.
- "Pyje me pishë të zezë", janë evidentuar në një sipërfaqe prej 91.8 ha, ose në 1.5% të totalit të përgjithshëm të sipërfaqes. Janë pyje artificialë, të kultivuar gjatë viteve 1981 dhe aktualisht në një moshë 45 vjeçare. Janë 100% në formëne qeverimit trungishte. Megjithë vështirësitë e hasura në arealin ku janë implantuar, ka filluar ripërtëritja natyrale nën masiv, gjë e cila tregon se lloji preferon stacionin ku është kultivuar.
- "Pyje me pishë të zezë me dushqe", është një tip pyjor mjaft interesant për t'u marrë në konsideratë, dhe është e kundërta e tipit të mësipërm. Origjina e këtij tipi pyjor në këtë ekonomi, sigurisht që është artificiale nëpërmjet pyllëzimeve. Por ajo që vihet re aktualisht, është prezenca e dushqeve të cilët po fitojnë terren dhe mesa shikohet shumë shpejt do të konvertojnë grumbullin në atë tipik natyral të zonës, dmth pyje me dushqe.
- "Pyje me ah", një tip pyjor edhe ky karakteristik për nga forma e përhapjes por edhe rezistenca ndaj ndryshimeve klimatike dhe ngrohjes globale. Është 100% natyral dhe në formën e qeverimit trungishte.
- "Pyje me makie" është tipi i pyjeve i cili në fakt i përket dominancës së llojit bush, por në sajë të mos-eksistencës së një tipi pyjor karakteristik për këtë lloj, e kemi pozicionuar në

këtë tip pyjesh. Lloji dominues është bushi i shoqëruar sigurisht nga dëllinj e kuqe. 100% në formën e qeverimit shkurre dhe i dëmtuar rëndë nga flutura me të njëjtin emër.

- "Pyje qarri me shkozë" është tipi i pyjeve i radhës për nga shtrirja në sipërfaqe në një madhësi prej 18.4 ha. Dominohet nga lloji qarr dhe shkoza si lloj shoqërues. Është 100% në formën e qeverimit cungishte.
- "Pyje azonale (te luginave ose bregut)", janë pyje të cilat shtrihen përgjatë luginave në shtretërit e lumenjve ose të përrenjve. Ky tip pyjor vërehet kryesisht në shtratin e lumit Shkumbin dhe përbëhet nga lloje tipik si vërriu, plepi, shelgu, rrapi dhe akacia. Është kryesisht në formën e qeverimit trungishte. Ky tip pyjor zë një sipërfaqe prej 17 ha.
- "Pyje bunge me ah" është një tjetër tip interesant pyjor i cili duhet të studiohet për nga rezistenca e ahut në kushtet e ndryshimeve klimatike dhe rritjes së temperaturave mesatare vjetore. Ky tip shtrihet në 8.3 ha të ekonomisë dhe zotërohet nga lloji bung dhe shoqërues është ahu. Është 100% në formën e qeverimit cungishte e përbërë, e cila presupozon që grumbulli dominohet nga cungishtja me përzierje të llojeve në formën e qeverimit trungishte.

Nga sa më sipër konkludojmë se EP Prrenjas, për vetë pozicionin gjeografik dhe thyerjet karakteristike të terrenit që ka, ka një diversitet llojor të cilët diferencohen në 15 tipe të ndryshme pyjore.

V.4 Tipet e kullotave

Tipet e kullotave në zonën e studimit diferencohen në bazë të lartësisë mbi nivelin e detit. Për lartësisë së madhe mbi nivelin e detit dhe të klimës kontinentale që karakterizon EP Prrenjas, kullotat e kësaj ekonomie janë tërësisht verore. Megjithatë duhet theksuar se për shkak të shkak të ndryshimeve klimatike dhe rritjes së temperaturës mesatare vjetore, kullotat kanë pësuar një rritje të ndjeshme të periudhës dhe ciklit të kullotjes.

Duhet të theksojmë se kulotat në këtë ekonomi pyjore, përdoren kolektivisht nga banorët e zonave përreth tyre. Për shkak të rënies së numrit të krerëve dhe lëvizjeve migratore të popullatave lokale, kullotat aktualisht nuk vuajnë nga mbikullotja, por për fat të keq po itensifikohet zvogëlimi i sipërfaqeve të tyre në sajë të ekspansionit të pyllit drejt tyre.

Në formë tabelare kullotat paraqiten si më poshtë:

Tipi i kullotës	Sipërfaqja (në ha)	% of totalit të sipërfaqes kullosore	% e totalit të së zonës së studimit
Kullotë verore	986.7	100	12.4
Kullotë dimërore	0	0	0
Totali	**986.7**	**100%**	**12.4**

Nga inventarizimi i terrenit rezulton se kullotat nuk janë trajtuar e as përmirësuar gjatë këtyre viteve, duke bërë që ato të kenë më shumë gurë në sipërfaqe dhe barëra të këqija. Megjithatë është konstatuar se veprat ujëpirëse për blegtorinë si lerat dhe koritat janë meremetuar e riparuar në më shumë se dy raste. Në objektivat e këtij plani mbarështimi, rreth 80% e sipërfaqes kullosore të kësaj ekonomie, do t'i nënshtrihet punimeve përmirësuese dhe gjithashtu 3 lera janë planifikuar për t'u ndërtuar.

V.5 Tipet e vegjetacionit potencial

Tipet e vegjetacionit potencial të ekonomisë pyjore Prrenjas, pothuajse përputhen me gjendjen reale te vegjetacionit aktual të vërejtura në këtë ekonomi. Megjithatë administrata përgjegjëse për administraimin e pyjeve në bashki duhet të tregohet më aktive sa i takon mbrojtjes së sipërfaqes dhe ndjekjes së zhvillimit të grumbujve. Tipet e vegjetacionit potencial të cilat pasqyrohen në tabelën më poshtë, janë rezultat i verifikimeve të kryera në terren nëpërmjet inventarizimit të grumbujve me sipërfaqe provë të përhershme dhe përpunimit të këtyre të dhënave nëpërmjet programit MS Access DB.

Në objektivat 10 vjeçare të këtij plani mbarështimi nuk janë parashikuar devijime nga potenciali prodhues i stacionit (vegjetacioni potencial), përkundrazi, në disa grumbuj ku ndërhyrjet humane janë drejt dështimit, do i jepet prioritet rikthimit të vegjetacionit outokton. Flasim këtu për disa pyllëzime të kryera si gjatë periudhës 1975-1981, por edhe disa të tjera të kryera gjatë viteve të tranzicionit, të cilat kanë shfaqur shenja të dështimit. Në këto sipërfaqe janë propozuar masa që favorizojnë llojet e dushqeve outoktone dhe është parashikuar zëvendësimi gradual i grumbujve, pa shkaktuar stres dhe erozion në sipërfaqe.

Njëkohësisht janë parashikuar ndërhyrje të cilat favorizojnë dhe përshpejtojnë rritjen e llojeve në përputhje me potencialet e stacionit, atu ku stacioni e lejon një gjë të tillë.

Tipet e vegjetacionit potencial sipas funksioneve/ perqindja ndaj totalit te siperfaqes pyjore

Tipi i vegjetacionit	Total		Funksioni							
			Prodhues		Mbrojtes		Rekreacion		Konservim	
	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %
Ekonomia pyjore EP Prrenjas										
Formacion ahishtesh	31.27	0.5	31.27	0.5	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Formacione pyjore te Pinus nigra Arnold,subsp.Pallasiana	126.27	2.0	126.27	2.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Formacione drunore te rrapishteve (platanus orientalis L.)	3.47	0.1	3.47	0.1	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Formacion druresh te shparthit	601.73	9.8	601.73	9.8	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Formacion pyjor. Quercus petraea	4411.7	71.5	4411.7	71.5	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Formacion pyjor me Quercus trojana Web.	946.54	15.3	946.54	15.3	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Formacione shkurrore me Myrtus comunis L.Pistacia lentiscus L.	29.21	0.5	29.21	0.5	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Formacione shkurrore te Quercus ilex L. dhe Quercus coccifera L.	11.58	0.2	11.58	0.2	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Vegjetacioni pyjor higrofit (klasa Alno - Populetea)	7.93	0.1	7.93	0.1	0	0.0	0	0.0	0	0.0
TOTALI I EKONOMISE :	**6169.653**	100.0	6169.7	100.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0

Nëse analizojmë të dhënat e pasqyruara në tabelën më sipër, ajo që bie në sy është fakti që EP Prrenjas është areal i dushqeve dhe llojeve që bëjnë pjesë në formacionin pyjor të bungës të ndjekura nga formacioni pyjor që dominohet nga bulgeri.

Në krahasim me planin e vjetër (1985) vërehet se formacionet pyjore të shparthit janë një risi për këtë plan mbarështimi. Kjo e dhënë tregon se mbase rrjeti i sipërfaqeve provë 200 x 200 m është më efikas sa i takon evidentimit të llojeve dhe parqyrimit sa më real të arealit të tyre.

V.6 Biodiversiteti


Fakti që EP Prrenjas mban në brendësi të saj zona të banuara, tregon qartë për një shrytëzim intensiv të resurseve natyraore të saj, duke bërë që natyraliteti të shkojë drejt asimilimit të plotë dhe biodiversiteti të mos shfaqë thekse të larta. Por gjithsesi, lëvizjet migratore të popullsisë që ndodhen në zonat e banuara në dhe në periferi të EP, kanë sjellë njëfarë qetesie që natyra duket se po e shfrytëzon në maksimum. Shumë sipërfaqe pyjore të cilat gjatë fillim viteve '90 ishin thuajse në prag të zhdukjes, tashmë duket se po ngrihen e përmirësohen gradualisht.

Më poshtë po paraqesim në formë tabelare të dhëna mbi shkallën e natyralitetit të evidentuara në EP Prrenjas, gjatë inventarizmit të terrenit.

Natyraliteti sipas funksioneve/ perqindja ndaj totalit te siperfaqes pyjore

Shkalla e natyralitetit	Total		Funksioni							
			Prodhues		Mbrojtes		Rekreacion		Konservim	
	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %
Ekonomia pyjore : EP Prrenjas										
Artificial	126.27	2.0	126.27	2.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
1/2 Natyral	6043.4	98.0	6043.4	98.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
TOTALI I EKONOMISE :	**6169.653**	100.0	6169.7	100.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0

Ne Total :



Sikurse mund të vërehet edhe nga tabela më sipër shkalla e natyralitetit ka një rritje të ndjeshmë vitet e fundit dhe shkaku i saj lidhet me zhvendosjen e popullsisë nga EP në drejtim të zonave urbane si dhe ulja e presionit të kullotjes dhe atyre të shfrytëzimit të burimeve natyrore. Kjo është shenjë se biodiversiteti në përgjithësi është drejt një përmirësimi natyral dhe të qëndrueshëm.
Një faktor tjetër që tregojnë eksistencën e biodiversitetit dhe vlerave të tij janë edhe biotopet specifike të vrojtuara në EP Prrenjas.
Sipas të dhënave nga programi MS Access DB, tabela e rezultateve Nr. 14 "Biotopet Specifike", rezultojnë këta të dhëna:

Kodi	Biotopi specifik	Sip. (në Ha)	% në lidhje me Sip. Totale pyjore
PN	Shoqërime pyjore afërsisht natyrore	6025.8	97.6
ND	Sipërfaqe që kanë ndërruar destinacion	132.2	2.1
PL	Shoqërime bimore përreth liqeneve (rezervuarëve)	11.6	0.3
TOTAL Sipërfaqes Pyjore		**6169.6**	**100**

Sikurse vërehet nga tabela, është shumë domethënëse fakti që mbi 97% e siipërfaqes pyjore ka biotope që janë afërsisht natyrore, gjë që tregon për ri-vendosjen e stadit klimaks në EP Prrenjas. Nga sa më sipërr konkludojmë se biodiversiteti në EP Prrenjas është drejt rivendosjes në ekuilibra natyror dhe vlera e tij është në rritje. Nuk paraqiten faktorë kërcënuesh momentalisht për biodiversitetin.

V.7 Prania e Vlerave Konservuese të Larta

Nga ekspeditat e kryera në terren në kuadër të inventarizimit me sipërfaqe provë, nuk janë vërejtur në të gjithë sipërfaqen e ekonomisë, prania e vendeve (siteve) me vlera të larta konservuese. Objektivat e këtij plani mbarështimi do të synojnë jo vetëm që të mos cënojnë biodiversitetin, por që të rrisin larminë e tij dhe të mbrojnë atë.

Nuk ka rrezik për biodiversitetin në sajë të masave të planifikuara në këtë plan mbarështimi.

V.8 Rreziku për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin

Objektivat e këtij plani mbarështimi do të synojnë jo vetëm që të mos cënojnë biodiversitetin, por që të rrisin larminë e tij dhe të mbrojnë atë.

Nuk ka rrezik për biodiversitetin në sajë të masave të planifikuara në këtë plan mbarështimi.

V.9 Mundësitë për aktivitete didaktike dhe kërkimore

Zona e studimit, nuk paraqet ndonjë interes apo vlerë të shtuar për aktivitete didaktike apo site kërkimore.

VI. Analizimi i të dhënave për pyjet dhe kullotat

VI.1 Analizimi i të dhënave për pyjet

VI.1.1 Analiza e tipeve pyjore

Ashtu si më sipër kemi theksuar, EP Prrenjas karakterizohet nga 15 tipe pyjore, të cilat janë evidentuar gjatë punës në terren dhe janë sistemuar nga programi i përpunimit të të dhënave. Mbështetur në madhësinë e sipërfaqes që zënë, në lidhje me totalin e sipërfaqes pyjore të gjetur në ekonomi, tipet e pyjeve renditen si më poshtë:

- "Pyje me bungë" është tipi që zotëron mbi të gjitha tipet e tjera pyjore që shfaqen në EP Prrenjas. Ai zë një sipërfaqë prej 1673 ha ose në 27% të totalit të ekonomisë. Në përbërjen llojore dominon bunga me grumbuj të thjeshtë dhe të pastër vetëm me llojin bung,

kryesisht. Ka prani kryesisht të dëllinjës së kuqe, qarrit dhe shkozës së zezë si lloje pjesëmarrës.

- "Pyje qarri me dushqe të tjerë", i cili shtrihet në një sipërfaqe prej 1323 ha ose në 21.4% të totalit të ekonomisë. Në përbërjen llojore të këtij tipi pyjor, kryeson qarri i cili shfaqet i përzier me llojet bungë, bulger ose shparth. Shkoza dhe dëllinja e kuqe shfaqen zakonisht si kat i dytë në këtë tip pyjor.
- "Pyje me bulger", është i treti për nga madhësia e sipërfaqes që zë në EP Prrenjas. Ky tip pyjor shtrihet në 964.3 ha ose në 15.6% të totalit të sipërfaqes së ekonomisë dhe dominohet tërësisht nga bulgeri, i cili ka tendencën të formojë grumbuj të pastër kryesisht. Dëllinjë e kuqe shoqëron kudo këtë tip pyjor, por si nënkat.
- "Pyje me shkozë të zezë", është tipi i katërt për nga madhësia e sipërfaqes që zë. Ky tip shtrihet në 652 ha ose në 10.6% të totalit të sipërfaqes së EP Prrenjas. Gjendet kryesisht në formën e qeverimit shkurre dhe ka pjesëmarrje të dushqeve kryesisht qarr e bungë.
- "Pyje me qarr", renditen në vendin e pestë për nga madhësia e sipërfaqes që zënë në ekonomi. Ato shtrihen në 509.8 ha, ose në 8.3 % të totali të sipërfaqes. Janë pyje të thjeshtë të qarrit me pjesëmarrje të dëllinjës së kuqe, shkozës dhe me rrallë akoma bungë, bulger e shparth. Janë 100% në formën e qeverimit cungishte.
- "Pyje shparti me dushqe të tjerë" është tipi në radhë, i cili shfaqet në 299.5 ha, ose në 5% të sipërfaqes së përgjithshme të ekonomisë. Dominohet nga lloji shparth, por me përzierje të kombinuar kryesisht me qarrin, bulgerin shkozën osë bungën më rrallë. Është 100% në formën e qeverimit Cungishte.
- "Pyje me shparth", shfaqen në 290 ha ose në 4.7 % të totalit të sipërfaqes së ekonomisë. Janë pyje të thjeshtë të shparthit por me pjesëmarrje te llojeve qarr kryesisht e shkozë. Janë 100% në formën e qeverimit cungishte.
- "Pyje shkoze me dushqe", janë tipi i tetë në renditje dhe zënë një sipërfaqe prej 226.7 ha, ose 3.7 % të totalit të përgjithshëm të sipërfaqes. Janë kryesisht në formën e qeverimit cungishte në masën 40% dhe në 60% të rasteve shfaqen si shkurre.
- "Pyje me pishë të zezë", janë evidentuar në një sipërfaqe prej 91.8 ha, ose në 1.5% të totalit të përgjithshëm të sipërfaqes. Janë pyje artificialë, të kultivuar gjatë viteve 1981 dhe aktualisht në një moshë 45 vjeçare. Janë 100% në formëne qeverimit trungishte. Megjithë vështirësitë e hasura në arealin ku janë implantuar, ka filluar ripërtëritja natyrale nën masiv, gjë e cila tregon se lloji preferon stacionin ku është kultivuar.
- "Pyje me pishë të zezë me dushqe", është një tip pyjor mjaft interesant për t'u marrë në konsideratë, dhe është e kundërta e tipit të mësipërm. Origjina e këtij tipi pyjor në këtë ekonomi, sigurisht që është artificiale nëpërmjet pyllëzimeve. Por ajo që vihet re aktualisht, është prezenca e dushqeve të cilët po fitojnë terren dhe mesa shikohet shumë shpejt do të konvertojnë grumbullin në atë tipik natyral të zonës, dmth pyje me dushqe.

- "Pyje me ah", një tip pyjor edhe ky karakteristik për nga forma e përhapjes por edhe rezistenca ndaj ndryshimeve klimatike dhe ngrohjes globale. Është 100% natyral dhe në formën e qeverimit trungishte.
- "Pyje me makie" është tipi i pyjeve i cili në fakt i përket dominancës së llojit bush, por në sajë të mos-eksistencës së një tipi pyjor karakteristik për këtë lloj, e kemi pozicionuar në këtë tip pyjesh. Lloji dominues është bushi i shoqëruar sigurisht nga dëllinj e kuqe. 100% në formën e qeverimit shkurre dhe i dëmtuar rëndë nga flutura me të njëjtin emër.
- "Pyje qarri me shkozë" është tipi i pyjeve i radhës për nga shtrirja në sipërfaqe në një madhësi prej 18.4 ha. Dominohet nga lloji qarr dhe shkoza si lloj shoqërues. Është 100% në formën e qeverimit cungishte.
- "Pyje azonale (te luginave ose bregut)", janë pyje të cilat shtrihen përgjatë luginave në shtretërit e lumenjve ose të përrenjve. Ky tip pyjor vërehet kryesisht në shtratin e lumit Shkumbin dhe përbëhet nga lloje tipik si vërriu, plepi, shelgu, rrapi dhe akacia. Është kryesisht në formën e qeverimit trungishte. Ky tip pyjor zë një sipërfaqe prej 17 ha.
- "Pyje bunge me ah" është një tjetër tip interesant pyjor i cili duhet të studiohet për nga rezistenca e ahut në kushtet e ndryshimeve klimatike dhe rritjes së temperaturave mesatare vjetore. Ky tip shtrihet në 8.3 ha të ekonomisë dhe zotërohet nga lloji bung dhe shoqërues është ahu. Është 100% në formën e qeverimit cungishte e përbërë, e cila presupozon që grumbulli dominohet nga cungishtja me përzierje të llojeve në formën e qeverimit trungishte.

Për të patur një informacion më të detajuar në lidhje me tipet e pyjeve të gjendura në EP Prrenjas, më poshtë po bëjmë një analizë të detajuar për secilin tip pyjesh.

1. **Tipi i pyjeve "Pyje me bungë".** Ky tip pyjesh zotëron karshi tipeve të tjera në ekonomi, me një sipërfaqe prej 1673 ha. Nga kjo, në formën e qeverimit cungishte gjenden 1477.3 ha (si në tabelen në vijim) mdërsa diferenca prej 195.7 ha, i përket formës së qeverimit shkurre.

Ekonomia Pyjore : EP Prrenjas

	Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi m3/ha	Totm3	rritja vij m3/ha	Totm3
Cungishte thj.	**Pyje me bunge**								
	1-10 vjec	74.6	2.01	0.27	1303	6.02	449.1	0.70	52.61
	11-20vjec	1043.1	3.42	0.38	1216	16.13	16827.6	1.13	1175.59
	21-30vjec	349.6	10.53	0.93	861	68.28	23869.0	3.12	1089.04
	31-40vjec	10.0	24.12	1.91	1200	159.60	1596.5	4.78	47.86
Totali i shtreses:		**1477.3**	**5.17**	**0.51**	**1136**	**28.93**	**42742.2**	**1.60**	**2365.10**

Ky tip pyjesh në formën e qeverimit cungishte, është i shpërndarë në 4 klasa moshe, ku nga sa shihet më sipër, dominon në sipërfaqe klasa e moshës 11-20 vjec, ndërsa në volum zotëron klasa e moshës 21-30 vjeç. Ky tip pyjesh prodhon një volum total për ekonominë prej 42 742 m^3, me një volum **mesatar 29 m^3/ha.**

2. **Tipi i pyjeve "Pyje qarri me dushqe të tjerë**". Ky tip zë një sipërfaqe totale në ekonomi prej 1323 ha, ndërsa në formën e qeverimit cungishte ka një sipërfaqe prej 1310 ha, dhe 13 ha janë në formën e qeverimit shkurre për shkak të situatës së degraduar të tyre, të cilët janë pa volum të llogaritshëm dhe nuk pasqyrohen në tabelat.

Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi m3/ha	Volumi Totm3	rritja vij m3/ha	rritja vij Totm3
Ekonomia Pyjore : EP Prrenjas								
Cungishte thj.	**Pyje qarri me dushqe te tjere**							
11-20vjec	1016.8	6.10	0.53	1387	33.67	34241.3	2.05	2082.46
21-30vjec	274.1	12.58	0.94	1253	77.54	21254.3	3.47	952.13
31-40vjec	19.2	15.79	1.11	900	109.85	2109.1	4.45	85.40
Totali i shtreses:	**1310.1**	**7.60**	**0.63**	**1351**	**43.97**	**57604.8**	**2.38**	**3120.00**

Sa i takon formës së qeverimit cungishte, ky tip pyjor zë një sipërfaqe të përgjithshme prej 1310 ha dhe sa u takon klasave të moshës klasa e dytë (11-20 vjeç) zotëron sipërfaqen prej 1017 ha, ndërsa peshën kryesore sa i takon volumit e mban klasa e tretë e moshës (21-30 vjec) me 21 254 m^3. Volumi mesatar i këtij tipi grumbulli është rreth 44 m^3/ha, në këtë formë qeverimi.

3. **Tipi i pyjeve "Pyje me bulger".** Ky tip pylli zë një sipërfaqe prej 964 ha. Sa i takon formës së qeverimit cungishte ai ka këtë paraqitje, ndërsa sipërfaqja prej 132.5 ha është në formën e qeverimit shkurre e cila nuk ka volum të llogaritshëm për shkak të gjendjes së degraduar.

Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi m3/ha	Volumi Totm3	rritja vij m3/ha	rritja vij Totm3
Ekonomia Pyjore : EP Prrenjas								
Cungishte thj.	**Pyje me bulger**							
11-20vjec	605.7	6.56	0.58	997	38.62	23394.8	2.31	1397.08
21-30vjec	225.8	8.35	0.57	1025	50.89	11492.7	2.33	525.93
Totali i shtreses:	**831.5**	**7.04**	**0.57**	**1005**	**41.95**	**34887.5**	**2.31**	**1923.01**

Sa më sipër vërehet, ky tip pyjor ofron një volum total prej 34887 m^3. Sipërfaqen më të madhe e zë klasa e parë e moshës (11-20 vjeç) dhe po ashtu edhe peshën më të madhe në volum e mban po kjo klasë moshe me 23395 m^3. Rritja mesatare llogaritet rreth 42 m^3/ha.

4. **Tipi i pyllit "Pyje me shkozë të zezë".** Ndonëse ky tip zë një sipërfaqe të konsiderueshme në ekonomi, nuk ka peshë në volumin e saj. Kjo pasi forma e degraduar e saj nuk krijon volum të llogaritshëm. Për këtë arsye ajo nuk ka tabelë përputhshmërie në program.
5. **Tipi i pyllit "Pyje me qarr".** Ky tip grumbulli gjendet tërësisht në formën e qeverimit cungishte më një sipërfaqe prej 449 ha. Formon vetëm dy klasa moshe, ku klasa e dytë e moshës dominon në sipërfaqe por njëkohësisht ajo bart edhe volumin më të madh prej 4759 m^3. Volumi total që ofron ky tip është 4759 m^3, dhe rritja mesatare është rreth 16 m^3/ha.

	Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi m3/ha	Totm3	rritja vij m3/ha	Totm3
Ekonomia Pyjore :	***EP Prrenjas***								
Cungishte thj.	**Pyje me qarr**								
	11-20vjec	351.6	3.01	0.27	1313	13.54	4759.1	1.07	375.55
	21-30vjec	97.2	4.94	0.36	1352	24.45	2376.0	1.44	140.41
Totali i shtreses:		**448.8**	**3.43**	**0.29**	**1321**	**15.90**	**7135.2**	**1.15**	**515.95**

Sikurse edhe shikohet nga tabela lloji kryesor i këtij tipi është lloji qarr, ndonëse ka dhe pjesëmarrje të llojeve të tjera dushqesh si bungë, shparth apo bulger e shkozë e zezë.

6. **Tipi i pyllit "Pyje shparti me dushqe të tjerë".** Ky tip pylli përbëhet kryesisht nga shparthi, por ka edhe përzierje të qarrit, bungës e shkozës së zezë.

	Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi m3/ha	Totm3	rritja vij m3/ha	Totm3
Ekonomia Pyjore :	***EP Prrenjas***								
Cungishte thj.	**Pyje shpardhi me dushqe te tjere**								
	11-20vjec	119.8	7.70	0.63	1312	43.38	5198.6	2.68	321.05
	21-30vjec	179.7	11.61	0.78	1016	71.55	12859.2	3.44	617.36
Totali i shtreses:		**299.5**	**10.05**	**0.72**	**1134**	**60.28**	**18057.8**	**3.13**	**938.41**

Në këtë tip pyjor, ofrohet një volum i përgjithshëm prej 18058 m^3. I gjithë tipi shtrihet vetëm në dy klasa moshe klasa e dytë dhe e tretë e moshës. Klasa e tretë e moshës (21-30 vjeç) zotëron këtë tip pylli si në sipërfaqe ashtu edhe në volum. Ky tip pyjor ka një rritje mesatare të konsiderueshem prej 60 m^3/ha.

7. **Tipi i pyllit "Pyje me shparth".** E gjithë sipërfaqja prej 290 ha ndodhet në formën e qeverimit cungishte. Edhe ky tip, shtrihet në vetëm 2 klasa moshe atë të II dhe të III.

	Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi m3/ha	Totm3	rritja vij m3/ha	Totm3
Ekonomia Pyjore :	***EP Prrenjas***								
Cungishte thj.	**Pyje me shpardh**								
	11-20vjec	156.9	8.64	0.57	1224	53.12	8334.9	2.84	445.61
	21-30vjec	133.1	13.22	0.80	1383	78.08	10396.4	4.06	540.40
Totali i shtreses:		**290.1**	**10.74**	**0.68**	**1297**	**64.58**	**18731.3**	**3.40**	**986.02**

Ofron një volum të përgjithshëm prej 18731 m^3, me një volum mesatar të konsiderueshëm rreth 65 m^3/ha. Si volumi dhe sipërfaqja janë të përqendruar në klasën e tretë të moshës (21-30 vjeç).

8. **Tipi i pyllit "Pyje shkoze me dushqe",** zë një sipërfaqe të përgjithshme prej 227 ha, ku vetëm 41 ha janë në formën e qeverimit cungishte, ndërsa pjesa tjetër janë në formën e qeverimit shkurre, pa volum të llogaritshëm.

	Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi m3/ha	Totm3	rritja vij m3/ha	Totm3
Ekonomia Pyjore :	***EP Prrenjas***								

Cungishte thj.	Pyje shkoze me dushqe								
	11-20vjec	3.6	2.75	0.28	1400	11.90	43.3	1.08	3.91
	21-30vjec	37.3	7.68	0.54	1700	41.20	1535.5	2.16	80.60
Totali i shtreses:		**40.9**	**7.24**	**0.52**	**1673**	**38.60**	**1578.8**	**2.07**	**84.51**

Volumi që ofron ky tip grumbulli është 1578 m^3. Si volumi dhe sipërfaqja janë të përqëndruar në klasën e tretë të moshës (21-30 vjeç). Ka një volum mesatar prej 38.6 m^3/ha.

9. **Tipi i pyllit "Pyje me pishë të zezë".** Shfaqen në 92 ha dhe janë të gjitha në formën e qeverimit trungishte.

Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi		rritja vij	
					m3/ha	Totm3	m3/ha	Totm3

Ekonomia Pyjore : EP Prrenjas

Trung	Pyje me pishe te zeze								
	41-60vjec	89.4	17.70	0.68	596	108.31	9684.4	4.39	392.46
Totali i shtreses:		**91.8**	**17.23**	**0.66**	**581**	**105.48**	**9684.4**	**4.27**	**392.46**

Duke qenë grumbull i formuar nga pyllëzimet artificiale të viteve 1981, grumulli është i gjithi njëmoshar (45 vjeç). Ofron për EP Prrenjas një volum lënde drusore më këmbë prej 9684 m^3 dhe ka një rritje mesatare 105 m^3/ha.

10. **Tipi i pyllit "Pyje me pishë të zezë me dushqe".** Shtrihet në 34.5 ha dhe e gjitha është në formën e qeverimit trungishte.

Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi		rritja vij	
					m3/ha	Totm3	m3/ha	Totm3

Ekonomia Pyjore : EP Prrenjas

Trung	Pyje pishe te zeze me dushqe								
	41-60vjec	34.5	21.06	0.82	650	94.38	3251.2	5.06	174.46
Totali i shtreses:		**34.5**	**21.06**	**0.82**	**650**	**94.38**	**3251.2**	**5.06**	**174.46**

Është i gjithi njëmoshar dhe ofron një volum të përgjithshëm prej 3251 m^3. Ka një rritje mesatare prej 94 m^3/ha.

11. **Tipi i pyllit "Pyje me ah".** Ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 31 ha dhe është e gjitha në formën e qeverimit trungishte.

Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi		rritja vij	
					m3/ha	Totm3	m3/ha	Totm3

Ekonomia Pyjore : EP Prrenjas

Trung	Pyje me ah								
	21-40vjec	31.3	8.24	0.84	1050	59.85	1871.5	6.14	191.99
Totali i shtreses:		**31.3**	**8.24**	**0.84**	**1050**	**59.85**	**1871.5**	**6.14**	**191.99**

Ka një volum të përgjithshëm prej 1871 m^3 me një ritje mesatare prej afro 60 m^3/ha. Janë të gjitha në klasën e II të moshës (21-40 vjeç).

12. **Tipi i pyllit "Pyje me makie".** Është i gjithi në formën e qeverimit shkurre. Përbëhet kryesisht nga llojet bush e dëllinjë dhe nuk ka volum të llogaritshëm.

13. **Tipi i pyllit "Pyje qarri me shkozë".** Ky tip grumbulli shtrihet në 18.4 ha dhe është i gjithi në formën e qeverimit cungishte.

Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi m3/ha	Volumi Totm3	rritja vij m3/ha	rritja vij Totm3

Ekonomia Pyjore : EP Prrenjas

Cungishte thj.	Pyje qarri me shkoze								
	21-30vjec	18.4	15.88	1.13	1950	95.78	1762.3	4.51	82.98
Totali i shtreses:		**18.4**	**15.88**	**1.13**	**1950**	**95.78**	**1762.3**	**4.51**	**82.98**

Përbehet vetëm nga një klasë moshe, 21-30 vjeç, dhe ka një volum të përgjithshëm prej 1762 m^3, me një volum mesatar prej 96 m^3/ha.

14. **Tipi i pyllit "Pyje azonale (te luginave ose bregut)".** Ky tip pylli përfaqëson llojet përgjatë rrjedhave ujore, kryesisht të shtretërve të përrenjve apo lumenjve. Në rastin konkret të lumit Shkumbin.

Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi m3/ha	Volumi Totm3	rritja vij m3/ha	rritja vij Totm3

Ekonomia Pyjore : EP Prrenjas

Trung	Pyje azonale (pyje te luginave ose te bregut)								
	21-40vjec	6.0	19.84	0.91	700	171.15	1020.1	10.33	61.57
	41-60vjec	11.4	22.45	1.03	390	162.36	1850.9	7.52	85.73
Totali i shtreses:		**17.4**	**21.56**	**0.99**	**497**	**165.38**	**2870.9**	**8.48**	**147.29**

Ky tip grumbulli shtrihet në një sipërfaqe prej 18.4 ha dhe është i gjithi në formën e qeverimit trungishte. Shtrihet në klasën e II dhe të tretë të moshës dhe ofron një volum të përgjithshëm prej 2871 m^3. Zotëron si në sipërfaqe dhe në volum klasa e III e moshës (41-60 vjeç). Volumi mestar është 165 m^3/ha.

15. **Tipi i pyllit "Pyje bunge me ah".** Është tipi i pyllit që shtrihet në sipërfaqen më të vogël, në vetëm 8.3 ha.

Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi m3/ha	Volumi Totm3	rritja vij m3/ha	rritja vij Totm3

Ekonomia Pyjore : EP Prrenjas

Cungishte thj.	Pyje me bunge te perzier me ah								
	21-30vjec	8.3	18.22	1.59	1350	115.50	952.9	9.11	75.18
Totali i shtreses:		**8.3**	**18.22**	**1.59**	**1350**	**115.50**	**952.9**	**9.11**	**75.18**

Ofron një volum të përgjithshëm prej 952 m^3 dhe ka rritje mesatare 115 m^3/ha. Ky volum ofrohet nga bunga dhe ahu.

VI.1.2 Ndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas regjimit të qeverisjes

Në EP Prrenjas të tre format e qeverimit janë prezente në grumbujt e saj. Nga grumbullimi i të dhënave në terren dhe përpunimi i tyre në programin MS Access DB ka rezultuar kjo panoramë:

Regjimi i qeverisjes	Sipërfaqja (ha)	Volumi mesatar (m^3/ha)	Volumi i përgjitshëm në këmbë (m^3)
Trungishte	174.9	101.08	**17678**
Cungishte thjeshtë	4724.9	38.83	**183453**
Cubgishte përbërë	73.6	43.1	**3171**
Shkurre	1196.3	2.7	**3223**
Gjithsej	**6169.7**	**33.6**	**207525**

Ashtu sikure mund të vërehet edhe nga tabela më sipër, dominancën e volumit në ekonomi e mban forma e qeverimit cungishte e cila sigurisht që është në porpocion të drejtë edhe me madhëinë e sipërfaqes.

Volumi total i EP Prrenjas llogaritet në një total prej 20 525 m^3, e gjendur kjo në sipërfaqen pyjore prej 6169.7 ha, dhe me një volum mesatar (të llogaritur) 33.6 m^3/ha.

Dëshirojmë të theksojmë se programi i përpunimit të të dhënave nuk diferencon të dhëna tabelare as për formën e qeverimit shkurre dhe as për atë të cungishtes së përbërë. Të dhënat e pasqyruara në tabelën më sipër, janë marrë manualisht nga tabela 22/6, e rezultateve të programit MS Access DB, dhe janë renditur në tabelën e mësipëme për llogaritje.

VI.1.3 Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimtarisë së stacionit

Nga të dhënat e grumbulluar gjatë inventarizimit të pyjeve në terren dhe nga përpunimi i tyre në programin MS Acces DB, rezultojnë të dhënat e mëposhtme:

Forma e qeverimit	Sipërfaqe (në Ha)	Klasa e moshës (vite)	Klasa e prodhimit
Trungishte	37.3	II (21-40)	III
	137.6	III (41-60)	IV
TOT. Trung	**174.9**		
Cungishte thjeshtë	74.6	I (1-10)	V
	3302.1	II (11-20)	V

	1319.0	III (21-30)	V
	29.2	IV (31-40)	V
TOT. Cung. thj	**4724.9**		
Cungishte përbërë	12.5	II (11-20)	IV
	61.1	III (21-30)	V
TOT. Cung. Përb	**73.6**		
Shkurre	107.0	II (6-10)	V
	1058.4	III (11-15)	V
	30.9	IV (16-20)	
TOT shkurre	**1196.3**		

Ashtu sikurse mund të vërehet kasat e moshës janë thuajse të përqendruara në klasën e III (41-60 vjet) për formën e qeverimit Trungishte, gjë që tregon se pyjet janë njëmoshar dhe të kultivuar.

Ndërsa për formën e qeverimit cungishte ka realisht të evidentuara 4 klasa moshe, por përqendrimi i sipërfaqes prej 3302 ha, kryesisht në klasën e II të moshës (11-20 vjet), tregon dhe flet qartë që ringritja e pyjeve ka ndodhur në këta 20 vitet e fundit.

Të njëjtën logjikë paraqesin edhe shpërndarja e klsave të moshës dhe atyre të prodhimit në formën e qeverimit shkurre, ku sikurse mund të shikohet edhe këtu zotëron klasa e III e moshës më 1058 ha.

Si konkluzion, vërejmë se klasat e moshës në EP Prrenjas janë thuajse të përqendruara në intervalin kohor 10-20 vjet. Kjo gjë është mjaft domethënëse, dhe na tregon se zhvillimi (ringritja) e pyjeve ka ndodhur në këtë afat kohor, i cili përkon me lëvizjet masive demografike, pakësimin e bagëtive dhe uljen e presionit mbi sipërfaqet pyjore.

Një shpërndarje e tillë e klasave të moshës është katërcipërisht e pa-pranueshme nëse flasim për arritjen e vijueshmërisë së prodhimit në grumbujt pyjorë të EP Prrenjas. Për pasojë, në objektivat e këtij plani mbarështrimi nëpërmjet masave të planifikuara, është synuar që të krijohet shpërndarja uniforme e klasave të moshës në korelacion me sipërfaqen. Dhe veçanërisht kjo është synuar në formën e qeverimit cungishte dhe shkurre.

Duke qenë se klasa e prodimit lidhet me secilin lloj, më poshtë po japim të dhëna në lidhje me shpërndarjen e llojeve sipas klasave te prodhimit, sipërfaqes dhe vëllimit për formën e qeverimit trungishte:

Shperndarja e siperfaqes dhe vellimit sipas klases se prodhimit (Trungishte prodhuese)

Lloji	Kl.prodh	Sip ha	Volumi
Ekonomia Pyjore : EP Prrenjas			
AH		31.3	1871.5
	3	31.3	1871.5
AK		6.5	1110.2
	2	6.0	1020.1
	4	0.5	90.2
BUN		0.4	36.2
	5	0.4	36.2
KRE		0.3	60.2
	4	0.3	60.2
PIZ		123.5	12899.5
	4	8.0	1151.1
	5	115.4	11748.4
PL		2.2	338.2
	4	2.2	338.2
VEZ		7.9	1276.4
	3	5.7	879.9
	4	2.2	396.4
VI		0.5	85.9
	3	0.5	85.9
Totali i ekonomise :		**174.9**	**17678.1**

Si për klasat e moshës të gjetura në fomat e qeverimit, por edhe nga ato për secilin lloj, duket se ka një disporpocion midis sipërfaqes dhe llojit, duke mos arritur të garantojë vijueshmërinë e prodhimit. Për të aritur normalizimin dhe vijueshmërinë e prodhimit mbi bazën e llojeve, në objektivat e këtij plani janë parashikuar masa që synojnë një gjë të tillë.

Shperndarja e siperfaqes dhe vellimit sipas llojeve (Trungisht prodhuese)

Lloji	Sip ha		Volumi
	%ndr	%vol	Totm3
Ekonomia Pyjore : EP Prrenjas			
AH	0.0	31.3	1871.5
AK	0.0	6.5	1110.2
BUN	0.0	0.4	36.2
KRE	0.0	0.3	60.2
PIZ	0.0	123.5	12899.5
PL	0.0	2.2	338.2
VEZ	0.0	7.9	1276.4
VI	0.0	0.5	85.9
Totali i ekonomise :		**174.9**	**17678.1**

VI.2 Analizimi i të dhënave për kullotat

VI.2.1 Gjendja e kullotave

Ashtu si më sipër kemi theksuar EP Prrenjas ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 968 ha me kullota. Të gjitha ato janë kullota verore pa përjashtim. Gjendja e tyre është përgjithësisht e mirë, referuar kjo në faktin që numri i krerëve ka rënë dhe presioni dhe mbikullotja nuk janë më një problem për to. Megjithatë, lënia pas dore për një kohë të gjatë ka bërë që fillimisht kullotat të humbasin cilësinë dhe gradualisht po humbasin edhe sipërfaqe. Cilësia është ulur pasi në kullota janë shtuar bimët e këqija të cilat janë realisht me rezistente karshi thatësirës, e cila po zgjatet si në sezon por edhe jashtë tij. Po ashtu, sasia e kullotës është ulur ndjeshëm për shkak të shpërndarjes së gurëve në sipërfaqe, të cilët më parë kanë qenë të stivosur në breza dhe kontrolli i kullotës nga gurët dhe pastrimi i tyre bëhej periodikisht.

Një fenomen tjetër që vihet re dhe po zvogëlon gradualisht sipërfaqen e kullotave është ai i ekspansionit pyjor drejt sipërfaqeve kullosore. Kjo është kahu i kundërt i rënies së presionit nga kullotja dhe rënia e numrit të krerëve, pasi gradualisht në sipërfaqet kulosore vijnë ferrat të cilat bëhen strehë për farat e bimëve më të larta dhe kështu gradualisht kullotat po humbasin gjithnjë e më shumë terren.

Nga inventarizimi i sipërfaqeve provë në terren, rezulton që bimësia e kullotave të dominohet nga ajo graminace në masën mbi 60%. Leguminozet shfaqen në rreth 30% të sipërfaqes dhe ato janë të pranishme vetëm në pjesën e parë të fillimit të vegjetacionit deri në fundin e majit dhe fillimin e muajit qershor, më pas ato humbasin për t'u rikthyer në fillim të sezonit të reshjeve, kuptohet nesë temperaturat e favorizojnë një gjë të tillë.

Për fat të keq, gurët në sipërfaqe kanë një shtim të ndjeshëm duke bërë që sipërfaqja e kullotës të reduktohet gradualisht. Në objektivat e këtij plani mbarështimi janë planifikuar masa të cilat synojnë përmirësimin e kullotave nëpërmjet punimeve të grumbullimit të gurëve e heqjes së barërave e ferrave të këqija.

Tipet e kullotave në zonën e studimit diferencohen në bazë të lartësisë mbi nivelin e detit. Për lartësisë së madhe mbi nivelin e detit dhe të klimës kontinentale që karakterizon EP Prrenjas, kullotat e kësaj ekonomie janë tërësisht verore. Megjithatë duhet theksuar se për shkak të shkak të ndryshimeve klimatike dhe rritjes së temperaturës mesatare vjetore, kullotat kanë pësuar një rritje të ndjeshme të periudhës dhe ciklit të kullotjes.
Duhet të theksojmë se kullotat në këtë ekonomi pyjore, përdoren kolektivisht nga banorët e zonave përreth tyre. Për shkak të rënies së numrit të krerëve dhe lëvizjeve migratore të

popullatave lokale, kullotat aktualisht nuk vuajnë nga mbikullotja, por për fat të keq po itensifikohet zvogëlimi i sipërfaqeve të tyre në sajë të ekspansionit të pyllit drejt tyre.

Në formë tabelare kullotat paraqiten si më poshtë:

Tipi i kullotës	Sipërfaqja (në ha)	% of totalit të sipërfaqes kullosore	% e totalit të së zonës së studimit
Kullotë verore	986.7	100	12.4
Kullotë dimërore	0	0	0
Totali	**986.7**	**100%**	**12.4**

Nga inventarizimi i terrenit rezulton se kullotat nuk janë trajtuar e as përmirësuar gjatë këtyre viteve, duke bërë që ato të kenë më shumë gurë në sipërfaqe dhe barëra të këqija. Megjithatë është konstatuar se veprat ujëpirëse për blegtorinë si lerat dhe koritat janë meremetuar e riparuar në më shumë se dy raste. Në objektivat e këtij plani mbarështimi, rreth 80% e sipërfaqes kullosore të kësaj ekonomie, do t'i nënshtrihet punimeve përmirësuese dhe gjithashtu 3 lera janë planifikuar për t'u ndërtuar.
Dominanca e tipit të kullotave në ato verore lidhet me lartësinë mesatare mbi nivelin e detit. Këta kullota gjenden në rrëzë të malit të Nemërçkës në një lartësi prej 1000 m mbi nivel deti.

Kullotat në përgjithësi janë të pasura me bimësi barishtore, por rënia e numrit të krerëve dhe moskullotja e tyre ka bërë që të shtohet në to prania e fiereve, barërave të këqija dhe ferrat të cilat janë hapi i parë për fillimin e vendosjes të bimësisë drunore, gjë që përbën shkak për fillimin e pushtimit të tyre nga pylli ose i njohur me termin *"Ekspansioni pyjor drejt kullotave"* .

Ashtu si më sipër theksuam gjendja e kullotava është aktualisht e mirë, por e lënë pas dore në trajtimin periodik të saj dhe rënia e presionit të kullotjes, ka bërë që në sipërfaqe të shfaqen lloje te tjera të huaaj të cilat e ulin cilësinë e saj. Kullotat verore megjithëse të pasura me llojë barishtore dhe të njohura për vlerat e tyre, nuk kanë ujë, gjë që është një tjetër faktor kufizues i tyre. Speciet graminore kryesore ne keto kullota janë: *Dactylis glomerata, Poa annua dhe Avena fatua.* Një kufizim tjetër është prania e gurëve, e cila ndikon ne prodhimtarine e kullotave.

Mbështetur në kërkesën e blegtorëve për kullota verore, në këtë plan mbarështimi janë propozuar masa për përmirësimin e gjendjes aktuale të kullotave. Kështu në parcelën 42 c, janë planifikuar të ndërtohen dy lera dhe e gjithë sipërfaqja kullotë do t'i nënshtrohet përmirësimit të saj nëpërmjet grumbullimit të gurëve në toghje në të gjithë sipërfaqen, shkulja e barërave të këqija dhe e shkurreve që pengojnë kullotjen.

VI.2.2 Madhësia dhe vendndodhja e sipërfaqes kullosore

Sipas inventarizimit në terren dhe përpunimit të të dhënave nga MS Acces DB, rezulton të kemi një sipërfae prej 986.7 ha. Në formë tabelare kullotat paraqiten si më poshtë:

Tipi i kullotës	Sipërfaqja (në ha)	% of totalit të sipërfaqes kullosore	% e totalit të së zonës së studimit
Kullotë verore	986.7	100	12.4
Kullotë dimërore	0	0	0
Totali	**986.7**	**100%**	**12.4**

Nga inventarizimi i terrenit rezulton se kullotat nuk janë trajtuar e as përmirësuar gjatë këtyre viteve, duke bërë që ato të kenë më shumë gurë në sipërfaqe dhe barëra të këqija. Megjithatë është konstatuar se veprat ujëpirëse për blegtorinë si lerat dhe koritat janë meremetuar e riparuar në më shumë se dy raste. Në objektivat e këtij plani mbarështimi, rreth 80% e sipërfaqes kullosore të kësaj ekonomie, do t'i nënshtrihet punimeve përmirësuese dhe gjithashtu 3 lera janë planifikuar për t'u ndërtuar.

Sa i takon inventarit të kullotave dhe vendodhjes së tyre në ekonomi, rezulton tabela me të dhënat e mëposhtme:

Parcela/nënparcela	Sip (në ha)	Pronësia	Përdorimi	
51 014 c	1.5	Bashkiake		Kolektiv
51 014 d	2.2	Bashkiake		Kolektiv
51 014 e	0.7	Bashkiake	Familjar	
51 015 b	3.3	Bashkiake		Kolektiv
51 015 c	0.5	Bashkiake	Familjar	
51 015 c	0.5	Bashkiake	Familjar	
51 016 c	1.2	Bashkiake		Kolektiv
51 016 d	0.4	Bashkiake	Familjar	
51 016 e	0.7	Bashkiake	Familjar	
51 016 f	0.7	Bashkiake	Familjar	
51 017 b	0.9	Bashkiake	Familjar	
51 018 c	0.5	Bashkiake	Familjar	
51 0.35 b	5.5	Bashkiake		Kolektiv
51 035 c	1.6	Bashkiake		Kolektiv
51 035 d	0.8	Bashkiake		Kolektiv
51 055 b	1.0	Bashkiake		Kolektiv
51 056 b	3.3	Bashkiake		Kolektiv
51 068 b	0.5	Bashkiake		Kolektiv
51 069 b	5.2	Bashkiake		Kolektiv

51 069 b	1.0	Bashkiake		Kolektiv
51 073 b	1.1	Bashkiake		Kolektiv
51 075 b	0.75	Bashkiake	Familjar	
51 084 d	130.0	Bashkiake		Kolektiv
51 084 e	96.0	Bashkiake		Kolektiv
51 090 b	28.5	Bashkiake		Kolektiv
51 097 b	15.8	Bashkiake		Kolektiv
51 098 d	2.9	Bashkiake		Kolektiv
51 099 c	6.7	Bashkiake		Kolektiv
51 100 b	2.1	Bashkiake		Kolektiv
51 101 b	10.0	Bashkiake		Kolektiv
51 102 a	78.7	Bashkiake		Kolektiv
51 103 b	6.3	Bashkiake		Kolektiv
51 104 c	4.6	Bashkiake		Kolektiv
51 105 c	1.0	Bashkiake	Familjar	
51 108 c	1.9	Bashkiake		Kolektiv
51 109 c	1.3	Bashkiake		Kolektiv
51 110 c	19.3	Bashkiake		Kolektiv
51 113a	61.7	Bashkiake		Kolektiv
51 114 b	35.2	Bashkiake		Kolektiv
51 115 a	115.5	Bashkiake		Kolektiv
51 123 b	1.6	Bashkiake		Kolektiv
51 123 c	1.9	Bashkiake		Kolektiv
51 123 d	0.4	Bashkiake	Familjar	
51 123 e	0.5	Bashkiake	Familjar	
51 123 f	0.2	Bashkiake	Familjar	
51 123 g	0.7	Bashkiake	Familjar	
51 124 b	4.8	Bashkiake		Kolektiv
51 124 c	1.6	Bashkiake		Kolektiv
51 124 d	0.7	Bashkiake	Familjar	
51 124 e	0.8	Bashkiake	Familjar	
51 124 f	0.5	Bashkiake	Familjar	
51 134 d	16.4	Bashkiake		Kolektiv
51 148 b	1.0	Bashkiake		Kolektiv
51 149 c	1.0	Bashkiake		Kolektiv
51 150 c	2.7	Bashkiake		Kolektiv
51 150 d	0.9	Bashkiake		Kolektiv
51 150 e	0.3	Bashkiake		Kolektiv
51 151 b	10.4	Bashkiake		Kolektiv
51 152 b	0.9	Bashkiake		Kolektiv
51 152 c	0.7	Bashkiake		Kolektiv
51 153 c	1.4	Bashkiake		Kolektiv

51 153 d	0.4	Bashkiake		Kolektiv
51 153 e	6.3	Bashkiake		Kolektiv
51 154 c	1.1	Bashkiake		Kolektiv
51 154 d	1.6	Bashkiake		Kolektiv
51 154 e	1.1	Bashkiake		Kolektiv
51 155 c	1.0	Bashkiake		Kolektiv
51 156 c	5.5	Bashkiake		Kolektiv
51 156d	0.9	Bashkiake	Familjar	
51 158 c	8.2	Bashkiake		Kolektiv
51 159 c	1.4	Bashkiake		Kolektiv
51 159 d	0.8	Bashkiake		Kolektiv
51 159 e	1.2	Bashkiake		Kolektiv
51 160 c	5.3	Bashkiake		Kolektiv
51 161 b	4.2	Bashkiake		Kolektiv
51 163 b	163.7	Bashkiake		Kolektiv
51 167 b	0.5	Bashkiake		Kolektiv
51 170e	12.0	Bashkiake		Kolektiv
51 170 f	5.1	Bashkiake		Kolektiv
TOTAL	**986.7**	**Bashkiake**		

Ashtu sikurse mund të shikohet EP Prrenjas ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 987 ha. Pronësia e trajtuar në këtë plan mbarështimi është e gjitha bashkiake, ndërsa përdorimi varion sa mbi bazë familje dhe atë kolektive, por kjo e fundit zotëron.

VI.2.3 Altituda, pjerrësia, kundrejtimi dhe kushtet hidrologjike

Të dhënat për lartësinë mbi nivelin e detit, pjerrësinë dhe kundrejtimin në mënyrë të përgjithshme për secilën parcelë që përdoret për kullotë jepet në fletët e përshkrimit parcelar, bashkëlidhur këtij relacioni dhe pjesë përbërëse e tij.

Sa i takon kushteve hidrologjike, vlen të theksojmë se ne të gjithë sipërfaqen e kullotave verore ka burime apo prroska me ujë gjatë stinës së verës, por që nuk janë të mjaftushme për të plotësuar kërkesën dhe nevojën e blegtorisë, gjë që konsiderohet edhe si pengesa kryesore për kontraktimin e tyre.

Kundrejtimi dominues i kullotave është ai jugor dhe jug perëndimor. Si më sipër theksuam përveç masavë për përmirësimin e kullotës do të ndërtohen edhe tre lera për sigurimin e ujit për blegtorinë, ndërkohë që dy të tjera i kemi gjetur të riparuara gjatë punës inventarizuese në terren.

VI.2.4 Mbërritshmëria

Sipërfaqja kullosore ka nje mbritshmeri te mire për shka të afërsisë me zanat e banuara në brendësi dhe në periferi të ekonomisë. Aty ku rrjeti rrugor mungon, transporti është plotësisht i mundur me kafshë, pasi terreni është i butë dhe e mundëson një gjë të tillë.
Sa më sipër, thekssojmë e mbritshmëria është një faktor plotësues për kontraktimin e kullotave, ndërkohë që bashkia duhet të mirëmbajë rrjetin rrugor eksistues dhe të shtojë infrastrukturën tjetër pritëse për blegtorët në sipërfaqen kullosore të ekonomisë.

VI.2.5 Mbledhja e të dhënave për sipërfaqet e djegura në kullota

Gjatë vrojtimeve në terren dhe inventarizimit të zonës së studimit janë vërejtur fenomene te zjarrit të 4-5 viteve me parë në njolla të vogla, pasi siç edhe është theksuar nga banorët ai është vëv shumë shpejt nën kontroll duke mos shkaktuar dëme.
Në pjesën tjetër të ekonomisë nuk janë vërejtur zjarre.

VII. Rezultatet e inventarizimit të pyjeve dhe kullotave

VII.1 Rezultati i inventarizimit në pyje

VII.1.1 Analiza statistikore e inventarizimit të pyjeve

Inventarizimi i Ekonomise Pyjore Prrenjas pyje dhe kullota është mbështetur në manualin "Për hartimin e planeve të menaxhimit për pyjet dhe kullotat", miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresen Nr. 864 Prot, datë 30.01.2019. Ai u bazua në matjet e sipërfaqeve provë të përhershme dhe të përkohshme te vendosura sipas nje rrjeti te baraslarguar sistematik për shkak se ka avantazhe jo vetëm në aspektin e saktësisë, por gjithashtu në vlerësimin e ndryshimit të të dhënave në pyje nëpërmjet krahasimit midis inventarizimeve të njëpasnjëshëm. Gjithsej u matën 872 sipërfaqe provë të përhershme dhe 17 sipërfaqe provë të përkohshme të vendosura për arsye të përfaqësimit më të mirë të grumbullit.

Përdorimi i tokës	Nr. i sipërfaqeve provë përhershm	Nr. i sipërfaqeve provë të përkohëshme
Pyll	1542	78
Kullotë	245	
Sipërfaqe jo pyjore (djerr)	87	
Gjithsej	**1874**	**78**

Nga 1874 sipërfaqe provë gjithsej, 47 sipërfaqe kanë qene të pamundura për t'u mbërritur. Vlerësimi i gjendjes së tyre është bërë nga distanca më e afërt e mundshme.

Inventarizimi i pyjeve u krye në ndërthurje me ortofotot me rezolucion të lartë si një mjet për ndërtimin e rrjetit dhe shpërndarjes së sipërfaqeve provë. Përveç kësaj, vendndodhjet e sipërfaqeve provë u përcaktuan gjithashtu edhe në hartat topografike, të cilat së bashku me ortofotot u përdorën nga ekipet e terrenit për tëkompletuar inventarizimin.

Metodologjia e përdorur për ngritjen e rrjetit të sipërfaqeve provë ishte e njëjtë me atë të specifikuar në Udhëzuesin e PMPK të vitit 2019. Matjet u kryen në tre rrathë bashkëqendrorë në sipërfaqet provë, me sipërfaqe 25 m^2, 200 m^2 dhe 400 m^2, në mënyrë që të përfshiheshin të gjitha kategoritë diametrike të drurëve (1.3 m nga toka) në grumbujt pyjorë. Në sipërfaqen provë 25 m^2 u mblodhën të dhëna për ripërtëritjen natyrore dhe u matën drurët, diametri bazimetrik i të cilëve ishte nga 2 cm deri 7.5 cm. Sipërfaqet provë me këtë madhësi, u përdorën gjithashtu edhe për inventarizimin e kullotave dhe në vlerësimin e prodhimeve pyjore jodrusore. Në sipërfaqen e dytë provë (200 m^2) u matën drurët me diametër bazimetrik nga 7.51 cm deri 27.5 cm dhe në sipërfaqen e tretë provë (400 m^2) u matën vetëm drurët me diametër më të madh se 27.5 cm. Për të vlerësuar saktësinë e inventarizimit të pyjeve bazuar në volumin e përllogaritur për secilën sipërfaqe provë, ne vlerësuam parametrat e mëposhtëm:

- Shmangia standard e volumit ndërmjet sipërfaqeve provë;

$$S_x = \pm\sqrt{S_x^2} \qquad S_x^2 = \frac{\sum_{i=1}^{n} x_i^2 - \frac{(\sum_{i=1}^{n} x_i)^2}{n}}{n-1}$$

- Koefiçienti i variacionit të volumit ndërmjet sipërfaqeve provë;

$$S_{x\%} = \frac{S_x}{\bar{x}} \cdot 100$$

- Gabimi standard në metër kub dhe përqindje;

$$S_{\bar{x}} = \frac{S_x}{\sqrt{n}}$$

Bazuar në këto ekuacione ne vlerësuam saktësinë e volumit ndërmjet sipërfaqeve provë dhe gjetëm që gabimi standard në llogaritjen e volumit ishte 5.9%. Ky gabim është jodomethënës, që do të thotë se të dhënat e volumit të siguruara nga inventarizimi në terren janëbrenda kufirit të gabimit (± 20 %).

VII.1.2 Volumi në këmbë dhe rritja e grumbujve pyjorë

Nga inventarizimi i grumbujve të EP Prrenjas, rezulton një volum drusor në këmbë prej 207525 m^3 (meter kub), të vendosura në në sipërfaqe pyjore prej 6169.7 ha, dhe me një volum mesatarpër ha 33.6 m^3/ha. Tabela më poshtë paraqet të dhëna të detajuara për volumin në këmbë, volumin mesatar në korelacion me sipërfaqen.

Regjimi i qeverisjes	Sipërfaqja (ha)	Volumi mesatar (m^3/ha)	Volumi i përgjitshëm në këmbë (m^3)
Trungishte	174.9	101.08	**17678**
Cungishte thjeshtë	4724.9	38.83	**183453**
Cubgishte përbërë	73.6	43.1	**3171**
Shkurre	1196.3	2.7	**3223**
Gjithsej	**6169.7**	**33.6**	**207525**

Ndërsa të dhëna të detajuara në nivel ngastre dhe/ose nënngastre mbi sipërfaqen, llojin, numrin e drurëve për 1 hektarë, të dhënat dendrometrke (Dm, Hm, Mosha, etj.), rritja mesatare dhe të dhëna të tjera, gjenden në tabelat në vijim të këtij relacioni.

VII.1.3 Struktura vertikale

Gjatë punës së inventarizimit nëpërmjet sipërfaqeve provë në terren, vërehen diferencimet e katit ndërmjet llojeve si dhe formë të ndryshme qeverimi si në tabelat më poshtë.

Theksojmë se diferencimi në nivel kati bëhet në nivel të tipit të grumbullit, ndërsa në nivel të llojit apo e thënë ndryshe në nivel të n/ngastrës, ai gjendet në skedën e përshkrimit parcelar.

Ekonomia Pyjore : EP Prrenjas

Cung.perb. **Prodhues**			
Pyje me qarr		**61.08**	**83**
	Nje kat	61.08	100
Pyje qarri me dushqe te tjere		**12.52**	**17**
	Nje kat	12.52	100
	Totali i shtreses :	**73.6**	
Cungishte thj. **Prodhues**			
Pyje me bulger		**831.548**	**18**
	Nje kat	585.726	70
	Dy kate	245.822	30
Pyje shkoze me dushqe		**40.905**	**1**
	Nje kat	40.905	100
Pyje qarri me shkoze		**18.4**	**0**
	Dy kate	18.4	100
Pyje me qarr		**448.765**	**9**
	Nje kat	448.765	100
Pyje qarri me dushqe te tjere		**1310.14**	**28**
	Nje kat	942.072	72
	Dy kate	368.07	28
Pyje me shpardh		**290.052**	**6**
	Nje kat	242.352	84
	Dy kate	47.7	16
Pyje shpardhi me dushqe te tjere		**299.548**	**6**
	Nje kat	246.048	82
	Dy kate	53.5	18
Pyje me bunge te perzier me ah		**8.25**	**0**
	Nje kat	8.25	100
Pyje me bunge		**1477.29**	**31**
	Nje kat	1192.923	81
	Dy kate	284.37	19
	Totali i shtreses :	**4724.90**	
Trung **Prodhues**			
Pyje me ah		**31.27**	**18**
	Nje kat	31.27	100
Pyje me pishe te zeze		**91.816**	**52**
	Nje kat	91.816	100
Pyje pishe te zeze me dushqe		**34.45**	**20**
	Dy kate	34.45	100
Pyje azonale (pyje te luginave ose te bregut)		**17.36**	**10**
	Nje kat	17.36	100
	Totali i shtreses :	**174.896**	
Shkurre **Prodhues**			
Pyje me makie		**29.21**	**2**
	Nje kat	29.21	100
Pyje me bulger		**132.74**	**11**
	Nje kat	132.74	100
Pyje shkoze me dushqe		**185.821**	**16**
	Nje kat	185.821	100
Pyje me shkoze te zeze		**652.163**	**55**
	Nje kat	652.163	100
Pyje me bunge		**196.32**	**16**
	Nje kat	196.32	100

Struktura	**Ha**	**%**
Totali i shtreses :	**1196.25**	
TOTALI I EKONOMISE :	**6169.65**	

VII.1.4 Cilësia e lëndës drusore në këmbë

Vlerësimi racional dhe kompleks i lëndës drusore kërkon njohuri të hollësishme të cilësisë së grumbujve pyjorë, jo vetëm në drejtim të volumit të përgjithshëm, por gjithashtu edhe në drejtim të vlerësimit të asortimenteve. Ky klasifikim është realizuar nga raporti i volumit të drurëve ekuivalentë me klasën e parë të cilësisë ndaj volumit të përgjithshëm. Kjo hipotezë vërtetohet kur kemi parasysh vetëm drurët e kategorisë së diametrave qendrorë, të cilët kanë peshën më të madhe në vëllimin e përgjithshëm të grumbujve pyjorë. Megjithëse nuk ka ndonjë vlerësim të cilësisë nga ekipet e inventarizimit në terren, në vlerësimin e cilësisë ne bazohemi në raportin e lëndës së punimit dhe druve të zjarrit ndaj volumit të përgjithshëm.
Duke qenë se grumbujt kanë lëndë drusore vetëm në kategorinë "dru zjarri", cilësia e tyre gjykohet në klasën e V të cilësisë.

VII.1.5 Biomasa dhe faktorët e ekspansionit të biomasës (BEF)

Grumbujt pyjorë te EP Prrenjas, luajnë një rol të rëndësishëm në sekuestrimin e karbonit dhe si rezultat llogaritja e biomasës është e rëndësishme. Për llogaritjen e biomasës mbitokësore ne përdorëm të dhënat e volumit të siguruara nga inventarizimi në terren dhe për t'i konvertuar në peshë të thatë përdorëm të dhënat e dendësisë nga Udhëzuesi i Panelit për Ndryshimet Klimatike (Panel for Climate Change) për speciet kryesore për regjimin e qeverisjes:

- Trungishte me llojin kryesor përfaqësues pishën e zezë, i cili gjendet në të gjithë Ekonomise Pyjore Prrenjas
- Cungishte dhe shkurre me llojet bungë, bulgeri, qarri dhe shkoza për pyjet cungishte dhe shkurre

Përmbajtja e karbonit në peshën e thatë të biomasës u konsiderua 0.5. Konvertimi nga C në CO_2 u bë duke u bazuar në peshën molekulare (CO_2/C = 44/12 = 3.667).
Për llogaritjen e biomasës mbitokësore përdorëm ekuacionin e mëposhtëm:

$B_{mbt}= Vt_{otal} \times Dd \times C_{ratio} \times BEF$

ku:

V_{total} – volumi i përgjithshëm për secilin regjim qeverisje

D_d – dendësia e peshës së thatë

C_{ratio} – përmbajtja e karbonit në biomasën e thatë (0.5)

BEF_Faktori i ekspansionit të biomasës

Duke ditur që: Vt= 207 525 m^3, Dd*C_{ratio}=8123; BEF=1.4, atëherë rezulton një biomasë mbitokësore në rreth 236 milion ton ekuivalent në CO_2, në të gjithë sipërfaqen pyjore të Ekonomise Pyjore Prrenjas.

VII.1.6 Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e Karbonit

Grumbujt pyjorë të EP Prrenjas kanë një ekuivalencë të sekuestrimit të karbonit në 236 milion ton. Kjo sasi e konsiderueshme i dedikohet moshës së re dhe vitalitetit të grumbujve.

Ekzistenca e tregjeve të karbonit në të ardhmen mund te jetë një burim fitimi i konsiderueshëm për pronarët e këtij grumbulli pyjor.

VII.2 Gjendja shëndetësore/fitosanitare

Gjendja shëndetësore dhe fitosanitare e grumbujve pyjorë përgjithësisht vlerësohet të jetë e mirë.

Në grumbujt pyjore te kesaj ekonomie, aktualisht nuk ka shenja të ndikimeve masive të patogjenëve, por kujtojmë që vite më parë, flutura e bushit shkaktoi një tharje masive të llojit me të njëjtin emër, duke shkatërruar me mijëra hekatarë më këtë lloj dhe duke i kthyer në toka kullota.

Njëkohësisht një problem shumë serioz mbetet edhe dëmtuesi i pishës së zezë, procesionaria, e cila shkakton dëmtime serioze të këtij lloji, duke e frenuar në rritje dhe në deformim të konusit të rritjes dhe të kërcellit gjithashtu.

Gjithashtu theksohet që **nuk ka raste të vëzhgimeve të tharjes së drurëve për shkak të ndryshimeve klimatike dhe përsëritjes së thatësirave, megjithëse grumbujt pyjorë do të ekspozohen veçanërisht në të ardhmen**, duke marrë në konsideratë kushtet specifike të zonës së studimit, të karakterizuara nga njëndryshueshmëri e altitudës, kundrejtimit dhe klimës.

VII.2.1 Drurët e tharë

Gjatë inventarizimit të grumbullit në terren, drurët e thatë i përkasin kryesisht kategorisë shkurre dhe veçanërisht atij të llojit bush dhe kjo lidhet dëmtimin e shkaktuar 3-4 vite më parë nga flutura

me të njëtin emër. Kategoria tjetër e drurëve të tharë, u përket rasteve të seleksionimit natyror, gjë e cila konsiderohet krejt normale për grumbuj të cilët hyjnë në konkurencë natyrale.

VII.2.2 Dëmtime të tjera

Nuk janë vërejtur dëmtime të tjera gjatë punës në terren në të gjithë sipërfaqen pyjore në EP Prrenjas

VII.3 Prerjet e paligjshme

VII.3.1 Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet në procesin e planifikimit

Siç është përmendur më sipër, prerjet e paligjshme jane prezente vetëm në afërsi të fshatrave të cila janë në afërsi të rrugës auto. Anës rrugës vërehen prerje, kryesisht të llojit bung, por jo në sasi që cënojnë vitalitetin dhe eksistencën e grumbullit të Ekonomise Pyjore Prrenjas. **Më tepër se sa prerjet e paligjshme, janë prerjet informale që zhvillohen në të gjithë ekonominë pyjore.** Në këtë mënyrë, secila familje per te plotesuar nevojat e saj per dru zjarri ose per gardhe, hunj etj presin nje pjese te materialit drusor ne keto ngastrat pyjore.

VII.3.2 Impakti i prerjeve ilegale në planifikimin dhe mbarështimin e pyjeve

Ashtu sikurse më sipër theksuam, prerjet ilegale kanë rënë në mënyrë të konsiderueshme dhe ato nuk përbëjnë një problem as në planifikimi afatgjatë dhe as në objektivat e përcaktuara në këtë plan mbarështimi.

VII.4 Rezultatet e inventarizimit të kullotave

VII.4.1 Tipi dhe cilësia e kullotave

Ashtu si më sipër kemi theksuar EP Prrenjas ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 968 ha me kullota. Të gjitha ato janë kullota verore pa përjashtim. Gjendja e tyre është përgjithësisht e mirë, referuar kjo në faktin që numri i krerëve ka rënë dhe presioni dhe mbikullotja nuk janë më një

problem për to. Megjithatë, lënia pas dore për një kohë të gjatë ka bërë që fillimisht kullotat të humbasin cilësinë dhe gradualisht po humbasin edhe sipërfaqe. Cilësia është ulur pasi në kullota janë shtuar bimët e këqija të cilat janë realisht me rezistente karshi thatësirës, e cila po zgjatet si në sezon por edhe jashtë tij. Po ashtu, sasia e kullotës është ulur ndjeshëm për shkak të shpërndarjes së gurëve në sipërfaqe, të cilët më parë kanë qenë të stivosur në breza dhe kontrolli i kullotës nga gurët dhe pastrimi i tyre bëhej periodikisht.

Një fenomen tjetër që vihet re dhe po zvogëlon gradualisht sipërfaqen e kullotave është ai i ekspansionit pyjor drejt sipërfaqeve kullosore. Kjo është kahu i kundërt i rënies së presionit nga kullotja dhe rënia e numrit të krerëve, pasi gradualisht në sipërfaqet kulosore vijnë ferrat të cilat bëhen strehë për farat e bimëve më të larta dhe kështu gradualisht kullotat po humbasin gjithnjë e më shumë terren.

Nga inventarizimi i sipërfaqeve provë në terren, rezulton që bimësia e kullotave të dominohet nga ajo graminace në masën mbi 60%. Leguminozet shfaqen në rreth 30% të sipërfaqes dhe ato janë të pranishme vetëm në pjesën e parë të fillimit të vegjetacionit deri në fundin e majit dhe fillimin e muajit qershor, më pas ato humbasin për t'u rikthyer në fillim të sezonit të reshjeve, kuptohet nesë temperaturat e favorizojnë një gjë të tillë.

Për fat të keq, gurët në sipërfaqe kanë një shtim të ndjeshëm duke bërë që sipërfaqja e kullotës të reduktohet gradualisht. Në objektivat e këtij plani mbarështimi janë planifikuar masa të cilat synojnë përmirësimin e kullotave nëpërmjet punimeve të grumbullimit të gurëve e heqjes së barërave e ferrave të këqija.

Tipet e kullotave në zonën e studimit diferencohen në bazë të lartësisë mbi nivelin e detit. Për lartësisë së madhe mbi nivelin e detit dhe të klimës kontinentale që karakterizon EP Prrenjas, kullotat e kësaj ekonomie janë tërësisht verore. Megjithatë duhet theksuar se për shkak të shkak të ndryshimeve klimatike dhe rritjes së temperaturës mesatare vjetore, kullotat kanë pësuar një rritje të ndjeshme të periudhës dhe ciklit të kullotjes.
Duhet të theksojmë se kullotat në këtë ekonomi pyjore, përdoren kolektivisht nga banorët e zonave përreth tyre. Për shkak të rënies së numrit të krerëve dhe lëvizjeve migratore të popullatave lokale, kullotat aktualisht nuk vuajnë nga mbikullotja, por për fat të keq po itensifikohet zvogëlimi i sipërfaqeve të tyre në sajë të ekspansionit të pyllit drejt tyre.

Në formë tabelare kullotat paraqiten si më poshtë:

Tipi i kullotës	**Sipërfaqja (në ha)**	**% of totalit të sipërfaqes kullosore**	**% e totalit të së zonës së studimit**
Kullotë verore	986.7	100	12.4

Kullotë dimërore	0	0	0
Totali	**986.7**	**100%**	**12.4**

Nga inventarizimi i terrenit rezulton se kullotat nuk janë trajtuar e as përmirësuar gjatë këtyre viteve, duke bërë që ato të kenë më shumë gurë në sipërfaqe dhe barëra të këqija. Megjithatë është konstatuar se veprat ujëpirëse për blegtorinë si lerat dhe koritat janë meremetuar e riparuar në më shumë se dy raste. Në objektivat e këtij plani mbarështimi, rreth 80% e sipërfaqes kullosore të kësaj ekonomie, do t'i nënshtrihet punimeve përmirësuese dhe gjithashtu 3 lera janë planifikuar për t'u ndërtuar.

VII.4.2 Përdoruesit e kullotave dhe koha e përdorimit

Si më sipër kemi theksuar, kullotat përdoren kryesisht nga banorët e fshatrave në brendësi të ekonomisë kolektivisht. Por ka dhe një sasi kullotash, sidomos ato në afërsi të shpive të banimit që janë rrethuar e përdoren privatisht nga banorët.

VII.4.3 Numri aktual i blegtorisë

Shumica e kafshëve përfaqësohet nga gjedhët, pasi është më i lehtë mbarështimi i këtyre llojeve, duke qenë se njerëzit kryesorë që merren me blegtori janë të moshuarit. Si pasojë e emigrimit dhe një rënie të fortë demografike, numri i bagëtive, të cilat zakonisht vlerësohen të jenë për nevojat e banorëve ka pësuar rënie. Në sasi, numri aktual i bagëtive ditët e sotme vlerësohet tëjete zvogeluar me rreth 50%. **Kjo rezulton në një ulje domethënëse të presionit të kullotjes mbi burimet pyjore,megjithëse ekuilibri ndërmjet numrit të bagëtive dhe kapacitetit mbajtës është ende larg për t'u arritur.**

VII.4.4 Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kafshëve

Parimi i përdorur për ndarjen e kullotave midis përdoruesve është "çdo fshat brenda kufijve të tij". Duke qenë se cilësia e sipërfaqeve kullosore është përgjithësisht e mirë, nga studimet e mëparshme supozohet që **kapaciteti mbajtës mesatar për 1 ha llogaritet të jetë 0.5 gjedhë, 3 dhi dhe 4 dele që mund të kullotin pa i shkaktuar dëme serioze ekosistemit.**

VII.4.5 Infrastruktura aktuale

Infrastruktura kullosore është përgjithsësisht e dobët. Prania e koritave prej druri apo çezmave të ndërtuara afër burimeve që shërbejnë si rezerva ditore për pirjen normale, përveç përrenjve sezonalë, nuk duhen neglizhuar dhe duhet investuar per to. Infrastruktura tjetër si rrjeti rrugor, gardhimet, sinjalistika, shenjat treguese të ndryshme për informim gjatë sezonit të kullotjes mungojnë pothuajse plotësisht. Duke parë këto mangësi, në bashkëpunim me banorët janë planifikuar që të ndërtohen 3 lera të reja dhe të meremetohen dy të tjera eksistuese.

VII.4.6 Problemet për kullotjen dhe furnizimin me bazë ushqimore për bagëtitë

Nuk janë konstatuar probleme të kullotjes dhe as te furnizimit të tyre me bazë ushqimore. Kjo në sajë edhe të rënies së numrit të krerëve, për shkak të lëvizjeve demografike të popullsisë drejt qendrave urbane.

VIII. Objektivat e planit të mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave

VIII.1 Objektivat e përgjithshme për planifikimin afatgjatë

Objektivat e këtij plani mbarështimi i referohen një periudhe 10 vjeçare dhe janë bazuar në gjendjen reale të pyjeve dhe sipërfaqes kullosore të ndodhur në konturet e Ekonomise Pyjore Prrenjas

Objektivat janë të përshkuar hollësisht në seksionin C. "Objektivat e mbarështrimit", të skedës së përshkrimit parcelar e cila gjendet bashkëlidhur këtij relacioni dhe janë pjesë përbërëse e këtij plani mbarështimi.

Në të gjitha njësitë e menaxhimit të pronës (nënparcela) ka objektiva për një zhvillim të qëndrueshëm të fondit pyjor apo kullosor. Kështu objektivat kryesorë në grumbujt pyjorë janë kryesisht ato që lidhen me sigurimin e gjeneratës së re të pyllit. Ky objektiv arrihet nëpërmjet ndërhyrjes së shfrytëzimit me breza.

Ndërsa për sipërfaqet kullosore, përmirësimi i cilësisë së kullotës nëpërmjet masave të grumbullimit të gurëve, heqjes e shkuljes së barërave e ferrave do të jenë objektivi i mirëmenaxhimit të tyre për një periudhë 10 vjeçare. Gjithashu ndërtimi i 3 lerave dhe meremetimi i dy lerave aktuale në kullotën veriore është një tjetër objektiv i cili do të garantojë kontraktim të garantuar të tipit të kullotave verore nga fermerët e zonës.

Njëkohësisht në objektivat e këtij plani mbarështimi do të jenë edhe përmirësimi i kullotave duke syniar jo vetëm shtimin e sipërfaqes por edhe duke rritur cilësinë e saj nëpërmjet pastrimit të gurëve, heqjes së barërave të këqija shkuljes së ferrave, etj.

VIII.2 Objektivat kombëtare për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave

Sikurse është shtjelluar në seksionet I.2 dhe II.2, ky PMPK u punua duke iu përmbajtur ngushtësisht rregullores dhe kuadrit politik kombëtar për mbarështrimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, ndër të cilët: ligji Nr. 57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet" dhe Dokumenti i Politikave Pyjore në Shqipëri, 2019-2030, miratuar me VKM Nr. 814, datë 31.12.2018.

VIII.3 Përputhshmëria me Planifikimin Bashkiak dhe Rajonal

Ky plan mbarështimi i pyjeve dhe kullotave të Ekonomise Pyjore Prrenjas u hartua në përputhshmëri të plotë me planet e zhvillimit rajonal dhe bashkiake dhe qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional. Ky plan mbarështrimi u zhvillua sipas parimit të transferimit të kompetencave dhe rritjes së ndërgjegjësimit midis aktorëve, pas një sërë takimesh me banore dhe perfasques te stafit te pyjeve te bashkise Prrenjas.
Si rrjedhim te dhenat e grumbulluara u integruanper te siguruar nje mbareshtrim te qendrueshem ne perputhje me kerkesat e popullsise lokale dhe pritshmerite e tyre. **Qëllimi i përgjithshëm ishte përcaktimi i masave dhe ndërhyrjeve, duke ekuilibruar burimet pyjore dhe kullosore me pritshmëritë e komunitetit lokal.** Raporti i procesit të pjesëmarrjes ofron më shumë hollësi rreth metodologjisë dhe rezultateve.

VIII.4 Objektivat kryesore të PMPK

Qëllimi kryesor i këtij PMPK është të sigurojë një mbarështrim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional të pyjeve dhe kullotave të Ekonomise Pyjore Prrenjas, duke balancuar aspektet

ekonomike, sociale dhe ekologjike, duke promovuar bashkërendimin e ngushtë ndërmjet stafit të pyjeve, popullsisë lokale dhe përfaqësuesve lokalë. Kjo përfundimisht do të lejojë **optimizimin e përfitimeve socio-ekonomike të burimeve për pronarët dhe palët e interesuara lokale sot dhe në të ardhmen.**

Në përputhje të plotë me objektivat e përgjithshme të përmendura në pjesën IX.1, qëllimet kryesore janë:

